# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5843
E premte, 2 gusht 2019
çmimi 0.40 €


## Meta: Tërhiqem nëse Rexhep Meidani bëhet president i Shqipërisë

FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", MILAZIM KRASNIQI FAQE 4-5



# Sejdiu, Haziri dhe Veliu janë kandidatë të kualifikuar për ta drejtuar LDK-në

Milazim Krasniqi, një ndër themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), ka bërë me dije se kjo parti duhet të lejojë garë fer për kryetar të ri, në të cilën mund të fitojë më i miri. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka thënë se vetëm në këtë mënyrë kjo parti mund të dalë më e fuqishme. Krasniqi është shprehur kundër idesë për një kandidat konsensual. Sipas tij, partitë demokratike nuk kanë nevojë për kandidat konsensual. Krasniqi ka theksuar se statuti aktual i LDK-së e favorizon liderin e partisë për ta fituar garën. Megjithatë, ai ka thënë se Fatmir Sejdiu, Lutfi Haziri dhe Agim Veliu janë kandidatë të kualifikuar për ta drejtuar LDK-në. Sipas tij, këto janë figura të vjetra dhe prominente të LDK-së

## Analistët: Pas dorëheqjes së kryeministrit, Kosova në udhëkryq

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka filluar konsultimet me partitë politike në lidhje me zhvillimet e fundit pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj. Ai ka deklaruar se do t'i shterojë të gjitha mundësitë që në konsultim me partitë politike të gjendet një përgjigje për realitetin e ri politik. Por, sipas Thaçit, nëse partitë politike nuk janë në gjendje t'i japin përgjigje këtij realiteti të ri politik, ai do t'i shpallë menjëherë zgjedhjet e reja. Këtë situatë të krijuar e kanë komentuar për "Epokën e re" analistët politikë Ramush Tahiri dhe Belul Beqaj. Ata kanë vlerësuar se pas dorëheqjes së kryeministrit, Kosova është në udhëkryq FAQE 3






## Përfaqësues të bizneseve dhe qytetarë kërkojnë përmbajtje nga premtimet elektorale karshi agjendës ekonomike

FAQE 9

## AKTUALE




VIHET GURTHEMELI I KULLËS SË HEROIT REXHEP MALA NË HOGOSHT F. 6

VESELI MERR PJESË NË MANIFESTIMIN TRADICIONAL NË VUTHAJ F. 6

NAIM BAZAJ I BASHKOHET AAK-së F. 6


## EKONOMI


KRU 'PRISHTINA', KONSUMATORËVE: PAJISUNI ME UJËMATËS F. 9

KEDS-I: INVESTIMET DO TA BËJNË DRENASIN 24 ORË ME ENERGJI ELEKTRIKE F. 9


## KULTURË


HAPET PANAIRI ARTIZANAL NË MALISHEVË F. 5




## SPORT


FFK-JA KËRKON NGA FIFA DHE UEFA NDALIMIN E GARAVE ILEGALE NË KOSOVË F. 18



RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Tomor Morina vazhdon të mbahet në paraburgim

SHKUP, 1 GUSHT - Gjasat që Tomor Morina të lirohet nga paraburgimi janë të vogla pavarësisht optimizmit të shprehur ditë më parë nga avokati Naser Raufi. Nga gjykata kompetente nuk japin informata se kur do të sjellin vendim lidhur me kërkesën e avokatit që Morina të mbrohet në liri, deri në shqyrtimin e kërkesës së Serbisë për ekstradimin e tij. Ministrja e Drejtësisë, Renata Deskoska, thotë se gjykatat janë ato që duhet të vendosin dhe se kërkesa nga shteti serb për ekstradimin e Morinës ende nuk ka arritur. "Ne deri tani si Ministri kemi kompetencë të vetme që përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme t'i njoftojmë ambasadat, shtetas i të cilave është personi në fjalë, i cili ka shtetësi të Britanisë dhe të Kosovës dhe ne në pajtim me ata procedura tashmë kemi njoftuar ambasadat. Deri të mërkurën në mbrëmje, por as sot nuk e kemi marrë kërkesën për ekstradim. Sapo ta marrim do ta dërgojmë te gjykatat të cilat do të duhet të vendosin ndaj asaj kërkese", deklaroi Renata Deskoska, ministre e Drejtësisë.
Ministri i Drejtësisë në Kosovë, Abelard Tahiri, përmes një kumtese për medie, arrestimin e Morinës me kërkesë të Serbisë e quajti shkelje flagrante të të drejtave të njeriut dhe mospërfillje të konventave ndërkombëtare.
Morina për më shumë se një javë po qëndron në paraburgim, ndërsa ishte arrestuar të mërkurën e kaluar nga policia maqedonase në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga INTERPOL-i, me kërkesë të Serbisë.



# Meta: Tërhiqem nëse Rexhep Meidani bëhet president i Shqipërisë

**Presidenti Ilir Meta tha se në rast se kërkon kryeministri mund ta lërë edhe detyrën e presidentit gjatë fushatës, vetëm me një kusht që në këtë zyrë të vijë një njeri me shumë integritet i cili ka qenë në këtë zyrë dhe ka provuar se mbrojtja e interesit kombëtar e publik është mbi çdo gjë tjetër, siç është profesor Rexhep Mejdani**



TIRANË, 1 GUSHT - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, propozon për kreun e shtetit emrin e Rexhep Mejdanit. Të enjten para gazetarëve Meta tha se 13 tetori është një mundësi për të gjithë ata që mendojnë se presidenti me qëndrimin e tij ka dëmtuar unitetin e popullit shqiptar dhe ua ka hequr të drejtën qytetarëve shqiptarë të ndëshkohet nga qytetarët shqiptarë me votën e tyre të lirë dhe demokratike. Madje ai tha se në rast se kërkon kryeministri mund ta lërë edhe detyrën e presidentit gjatë fushatës por, vetëm me një kusht, që në këtë zyrë të vijë një njeri me shumë integritet i cili ka qenë në këtë zyrë dhe ka provuar se mbrojtja e interesit kombëtar e publik është mbi çdo gjë tjetër dhe që nuk e ha shantazhin e presionin, siç është profesor Rexhep Mejdani. "Ne nuk kërkojmë zgjedhje daneze sepse është një çështje që kërkon kulturë tjetër, kod tjetër dhe nuk krijohet me 20 vjet e as 2 vjet. Por zgjedhje të standardeve që kemi pasur dhe më të mira e kemi detyrim, përndryshe kemi 0 pikë 0 % mundësi për t'i çelur negociatat në tetor me BE-në, mendoj se këtë e dinë mirë të gjithë.
Sa i takon presidentit, ajo që mund të bëjë është shumë e thjeshtë, që ka bërë gjithmonë sa herë vendi ka qenë në situata të tilla ta japë shembullin personal. Nuk do të bëhen zgjedhje parlamentare më 13 tetor, do të bëjmë edhe zgjedhje presidenciale, s'ka asnjë shqetësim bashkë me zgjedhjet vendore. Kjo është një mundësi për të gjithë ata që mendojnë se presidenti me qëndrimin e tij ka dëmtuar unitetin e popullit shqiptar dhe ua ka hequr të drejtën qytetarëve shqiptarë të ndëshkohet nga qytetarët shqiptarë më 13 tetor me votën e tyre të lirë dhe demokratike. Jo vetëm kaq sepse presidenti është edhe më i hapur pasi nuk ka frikë nga vota e qytetarëve shqiptarë që në rast se kërkon kryeministri ta lërë edhe detyrën e presidentit gjithmonë duke konkurruar më 13 tetor, përpara qytetarëve shqiptarë, por vetëm me një kusht që në këtë zyrë të vijë një njeri me shumë integritet i cili ka qenë në këtë zyrë dhe ka provuar se mbrojtja e interesit kombëtar e publik është mbi çdo gjë tjetër dhe që nuk e ha shantazhin e presionin, siç është profesor Rexhep Mejdani. Kjo është krejtësisht e zgjidhshme.
Unë nuk e kam biseduar këtë çështje me njeri, është një njeri që jam i sigurt ato 2-3 çështje të rëndësisë kombëtare që trajtohen nga kjo zyrë do t'i mbronte ndoshta dhe më mirë sesa unë. Kështu që mos të bëjmë sikur nuk shohim thellimin e krizës. Marrja e këtyre bashkive në këtë mënyrë nuk është e ligjshme. Nuk ka pasur zgjedhje të ligjshme, kushtetuese, shtetërore më 30 qershor dhe nuk është as e ligjshme të marrësh bashkinë e Kavajës, Kamzës, Shkodrës me 6-7 % dhe ta kesh kontrollin e gjithë administratës së bashkisë, gjithë shërbimeve të bashkisë, të kesh dhe gjithë këshillin, kjo është skandaloze. Sepse këtu bie totalisht sistemi i llogaridhënies dhe kjo nuk dëmton vetëm qytetarët shqiptarë që përkrahin opozitën dhe pa dyshim që për këtë situatë opozita ka një përgjegjësi historike, por penalizon edhe ata qytetarë që kanë votuar PS-në sepse kush do t'i mbrojë interesat e tyre nga abuzivizmi i kryetarëve që i përkasin vetëm një force politike dhe mund të bëjnë çdo gjë në kushtet e mungesës së një opozite", deklaroi Meta.

## Ruçi falënderon homologun italian Roberto Fico

TIRANË, 1 GUSHT - Kryeparlamentari Gramoz Ruçi i ka dërguar një letër falënderimi homologut italian Roberto Fico për rezolutën e miratuar ku kërkohet mbështetje të proceseve integruese të Shqipërisë dhe çeljes sa më shpejt të negociatave. Rezoluta është miratuar më 19 korrik nga Komisioni i Punëve të Jashtme dhe Komunitare të Dhomës së Deputetëve të Parlamentit italian. "Dëshiroj t'ju falënderoj për Rezolutën 'Mbi integrimin e Ballkanit Perëndimor në institucionet euroatlantike', miratuar njëzëri nga Komisioni i Punëve të Jashtme dhe Komunitare i Dhomës së Deputetëve të Parlamentit të Republikës Italiane më 19 korrik. Në rezolutë vlerësohen reformat e ndërmarra nga Shqipëria në kuadrin e përgatitjeve për çeljen e negociatave dhe i rekomandohet qeverisë italiane të mbështesë në mënyrë aktive dhe ta fuqizojë rolin e vet si një partner i vëmendshëm në mbrojtje të integrimit euroatlantik të vendeve të rajonit si dhe të paqes e stabilitetit të Evropës dhe Mesdheut", tha Ruçi, i cili shprehet i bindur në vendosmërinë që do të tregojë Roma në mbledhjen e Këshillit Evropian më 18 tetor, kur do të vendoset për negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Analistët: Pas dorëheqjes së kryeministrit, Kosova në udhëkryq

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka filluar konsultimet me partitë politike në lidhje me zhvillimet e fundit pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj. Ai ka deklaruar se do t'i shterojë të gjitha mundësitë që në konsultim me partitë politike të gjendet një përgjigje për realitetin e ri politik. Por, sipas Thaçit, nëse partitë politike nuk janë në gjendje t'i japin përgjigje këtij realiteti të ri politik, ai do t'i shpallë menjëherë zgjedhjet e reja. Këtë situatë të krijuar e kanë komentuar për "Epokën e re" analistët politikë Ramush Tahiri dhe Belul Beqaj. Ata kanë vlerësuar se pas dorëheqjes së kryeministrit, Kosova është në udhëkryq

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 1 GUSHT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka filluar konsultimet me partitë politike në lidhje me zhvillimet e fundit pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj. Thaçi fillimisht konsultimet i ka nisur me përfaqësuesit e partive të vogla nga radhët e komuniteteve. Presidenti deri më tani ka takuar përfaqësuesit e Partisë Demokratike Turke të Kosovës (KDTP) dhe ata të subjektit VAKAT nga grupi parlamentar 6 + dhe partitë e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas. Thaçi ka deklaruar se do t'i shterojë të gjitha mundësitë që në konsultim me partitë politike parlamentare të gjendet një përgjigje për realitetin e ri politik.

Po ashtu, Thaçi ka takuar edhe kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, me të cilën ka diskutuar rreth zgjedhjeve të parakohshme. Në këtë takim me kryetaren e KQZ-së, presidenti ka thënë se nëse partitë politike nuk janë në gjendje t'i japin përgjigje këtij realiteti të ri politik në një afat të arsyeshëm kohor, atëherë është i gatshëm t'i shpallë menjëherë zgjedhjet e reja.

Presidenti Thaçi ka theksuar se është thelbësore që Kosova të ketë qeveri të re, funksionale, efikase, sa më gjithëpërfshirëse dhe sa më të shpejtë për t'i çuar përpara proceset e rëndësishme.

Ndërkaq partitë politike sërish kanë kërkuar që zgjedhjet të shpallen sa më shpejt, ndonëse ende nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim në këtë drejtim.

Analistët politikë kanë thënë se zgjedhjet e parakohshme janë e vetmja zgjidhje që vendi të dalë nga kjo krizë e krijuar politike. Analisti politik Ramush Tahiri ka kritikuar pozitën dhe opozitën që këtij procesi t'i japin zgjidhje që çon në mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme. "Kosova duhet ta respektojë Kushtetutën, ligjet dhe procedurat e parapara. Të gjitha partitë kanë deklaruar se duan të shkojnë në zgjedhje, por asnjë parti nuk ka ndërmarrë asnjë iniciativë për ta çuar vendin në zgjedhje. Zyrtarisht nuk ka procedurë që të shkojë vendi në zgjedhje sepse z. Haradinaj në emër të partisë së tij nuk i ka dorëzuar kërkesë me shkrim presidentit se vendi duhet të shkojë në zgjedhje. Së dyti, asnjë parti politike, as nga PAN-i dhe as nga partitë e tjera, nuk i kanë dorëzuar letër zyrtare presidentit përmes së cilës tregohet se nuk janë të interesuara për asgjë tjetër, përveç mbajtjes së zgjedhjeve të reja. Subjektet politike të PAN-it do të duhej t'i dërgonin letër zyrtare presidentit, pra këtë do të duhej ta bënte z. Veseli në emër të këtij koalicioni. Përmes kësaj letre do të duhej të tregonin se nuk duan të propozojnë kandidat të ri për kryeministër ashtu si e parasheh nenin 95 i Kushtetutës, por duan të shkojnë në zgjedhje të parakohshme. Po ashtu, 40 deputetë të Kuvendit mund të kërkojnë seancë të jashtëzakonshme dhe në këtë seancë të propozohet shpërndarja e Kuvendit me dy të tretat e votave ose, së paku, 80 vota. Pas shpërndarjes së Kuvendit, presidenti vetëm e dekreton datën e zgjedhjeve të cilat duhet të mbahen jo më herët se tridhjetë ditë dhe jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit", ka thënë për gazetën "Epoka e re" Tahiri.

Ndërkaq analistit tjetër politik Belul Beqaj ka thënë se, pavarësisht prej insistimit për zgjedhje të parakohshme, asnjë prej subjekteve politike nuk janë të përgatitura për proces zgjedhor. Ai ka thënë se Kosova është në udhëkryq. Beqaj ka thënë se nëse mbahen zgjedhjet pa u kryer reforma zgjedhore, obligimet e dala nga procesi i dialogut dhe Kushtetuta, rezultati i zgjedhjeve do t'i përngjajë konfiguracionit aktual politik, por gjendja e përgjithshme në Kosovë do të jetë e pashpresë.



## Kryetari i PSD-së takohet me ambasadorin e Çekisë, bisedojnë për situatën politike

PRISHTINË, 1 GUSHT (ER) - Kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Shpend Ahmeti, dhe shefi i grupit parlamentar i PSD-së, Dardan Sejdiu, kanë pritur në takim ambasadorin e Republikës Çeke në Kosovë, Pavel Bilek.

Në takim u diskutua situata politike në vend, me ç'rast përfaqësuesit e PSD-së theksuan domosdoshmërinë e mbajtjes së zgjedhjeve të reja si e vetmja rrugë përpara. Më tej u diskutua për rëndësinë e lëvizjes së lirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Të dyja palët shprehën kënaqësinë për takimin dhe nevojën për takime të këtilla në të ardhmen.



Flet për "Epokën e re", Milazim Krasniqi

# Sejdiu, Haziri dhe Veliu janë kandidatë



Milazim Krasniqi, një ndër themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), ka bërë me dije se kjo parti duhet të lejojë garë fer për kryetar të ri, në të cilën mund të fitojë më i miri. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka thënë se vetëm në këtë mënyrë kjo parti mund të dalë më e fuqishme. Krasniqi është shprehur kundër idesë për një kandidat konsensual. Sipas tij, partitë demokratike nuk kanë nevojë për kandidat konsensual. Krasniqi ka theksuar se statuti aktual i LDK-së e favorizon liderin e partisë për ta fituar garën. Megjithatë, ai ka thënë se Fatmir Sejdiu, Lutfi Haziri dhe Agim Veliu janë kandidatë të kualifikuar për ta drejtuar LDK-në. Sipas tij, këto janë figura të vjetra dhe prominente të LDK-së

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 1 gusht** - Një ndër themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Milazim Krasniqi, ka ftuar lidershipin e kësaj partie që në Kuvendin e Nëntë Zgjedhor, i cili do të mbahet këtë të shtunë, të lejojë një garë fer për të gjithë ata që shprehin interesim për ta udhëhequr partinë. Ai ka bërë me dije se vetëm në këtë mënyrë kjo parti do të dalë më e fuqishme nga ky kuvend zgjedhor. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se kandidatët konsensualë nuk i shkojnë një partie demokratike. "Zakonisht partitë demokratike nuk kanë nevojë për kandidat konsensual. Të mërkurën e pashë debatin e Partisë Demokratike në ShBA, ku 20 kandidatë pretendojnë kreun e partisë dhe postin e presidentit. Ishte një debat dramatik në Detroit, ku secili shpaloste aspektet e programit të vet. Besoj se mënyra më e mirë e testimit të demokracisë së brendshme është që të ketë më shumë kandidatë dhe të jetë një garë korrekte, në të cilën mund do të fitojë më i miri. Pastaj të gjithë të bashkohen me kandidatin që do të fitojë", ka thënë Krasniqi.

Ai ka deklaruar se statuti aktual i partisë e favorizon liderin e partisë për të qenë sërish kryetar. "Absurdi është që në statutin e partisë e kanë futur normën që praktikisht mund të ketë vetëm një kandidat. Nëse kuvendi i ka mbi 350 delegatë dhe nëse për të kandiduar për kryetar të LDK-së kërkohen nënshkrimet e mbi 50 për qind të delegatëve, i bie që nuk ka mundësi të jenë dy kandidatë. Pra, qëllimisht është futur kjo normë në statut, në mënyrë që të pengohet gara demokratike", është shprehur Krasniqi. Ai ka vlerësuar se me udhëheqjen e Isa Mustafës, në LDK është ngulitur një mentalitet i vjetër.

**"Epoka e re":** *Z. Krasniqi, LDK-ja Kuvendin e Nëntë Zgjedhor do ta ketë të shtunën. Si një ndër themeluesit e kësaj partie në bazë të rrethanave ekzistuese, si prisni të shkojë ky kuvend?*

Krasniqi: Ky kuvend është i rregullt dhe, si i tillë, do të duhej të kalonte në një procedurë krejt normale. Nuk e kuptoj pse e kanë ngatërruar aq keq procesin e kandidimit të kandidatëve për kreun e partisë, ku zakonisht partitë i bëjnë transparente shumë më herët kandidaturat. Në këtë mënyrë kandidatët zakonisht paraqesin programet e tyre para anëtarësisë së partisë. Bile në rastin e LDK-së kjo do të duhej të ishte edhe më transparente, sepse pretendohet që kryetari i ardhshëm i LDK-së të jetë edhe kryeministër i vendit. Pra, këtu nuk ka qenë vetëm interesi i anëtarësisë së LDK-së, por edhe interesi i të gjithë qytetarëve të Kosovës që ta dinë se kush do të jetë kryetari i LDK-së. Por, mënyra që kanë zgjedhur më duket se është një mentalitet i vjetër, është një skemë e vjetër e partive të deklasuara historikisht, të cilat kanë bërë zgjedhje tinëz, natën me kandidatura e marrëveshje të fshehta.

**"Epoka e re":** *Pas mbledhjes së kryesisë së LDK-së që është mbajtur të enjten është thënë se po punohet për gjetjen e një kandidati konsensual. Kush mund të jetë, sipas jush, kandidat konsensual?*

**Krasniqi:** Zakonisht partitë

# të kualifikuar për ta drejtuar LDK-në



**"Epoka e re":** *Deri më tani publikisht disa zyrtarë të lartë të LDK-së kanë shprehur gatishmërinë për të kandiduar për të parin e partisë. Cilin e shihni më favorit?*

**Krasniqi:** Absurdi është që në statutin e partisë e kanë futur normën që praktikisht mund të ketë vetëm një kandidat. Nëse kuvendi i ka mbi 350 delegatë dhe nëse për të kandiduar për kryetar të LDK-së kërkohen nënshkrimet e mbi 50 për qind të delegatëve, i bie që nuk ka mundësi të jenë dy kandidatë. Pra, qëllimisht është futur kjo normë në statut, në mënyrë që të pengohet gara demokratike. Prandaj, në këtë aspekt është zor të parashikohet, sepse kufizimet në statut janë të atilla që favorizojnë një kandidat. Kur kemi favorizime të një kandidati, zakonisht favorizohet ai që është kryetar i partisë.

**"Epoka e re":** *Dhe në bazë të kësaj i bie që z. Mustafa mund të jetë prapë kryetar i LDK-së?*

**Krasniqi:** Nuk e di, por norma statutare të cilën ai e ka futur në statut, faktikisht këtë nënkuptim e ka. Përndryshe, mendoj se edhe kandidatët e tjerë janë të kualifikuar për ta drejtuar partinë, si presidenti Sejdiu, Haziri dhe Veliu. Këto janë figura të vjetra dhe figura prominente të LDK-së, të cilat janë edhe figura autentike të LDK-së. Nëse mendohet që LDK-ja të dalë edhe më e fuqishme nga ky kuvend duhet të lejohen kandidaturat e gjithë atyre që aspirojnë dhe pastaj të fitojë ai që merr vota më së shumti.

**"Epoka e re":** *Kufizimi i kandidaturave, sa mund ta nxisë përçarjen në këtë parti?*

**Krasniqi:** Kjo normë statutare e ka krijuar pikërisht këtë lloj konfliktualiteti, sepse duke e mbajtur favorizimin e një kandidati, në fakt ka krijuar frustrime në kuvend, siç ndodhi herën e kaluar kur nuk iu lejua kandidatura Vjosa Osmanit. Jam i bindur se zgjidhja më e mirë për LDK-në ka qenë që të futet në statut parimi një anëtar një votë. Në këtë rast, lideri do të kishte legjitimitetin e plotë të përfaqësimit. Kështu rrezikohet që grupet e ndryshme të interesit të bëjnë koalicione joparimore dhe të zgjedhin kryetar dikë që i ka ofertuar më shumë grupet e interesit, ose të ketë ashpërsim të komunikimit, eventualisht edhe fraksione.

**"Epoka e re":** *Në bazë të sondazheve del se LDK-ja është partia e parë në vend. Sa do të ndikojë mbarëvajtja e këtij kuvendi në reprezentimin e LDK-së në zgjedhjet e ardhshme të cilat pritet të mbahen së shpejti?*

**Krasniqi:** Nëse LDK-ja del nga kuvendi pa konflikte dhe pa ndonjë fraksion, realisht ajo mund të jetë partia kryesore në zgjedhjet e ardhshme. Ndoshta pikërisht edhe për këtë arsye edhe janë rritur apetitet e shumë kandidatëve dhe shumë grupeve. Mendoj se ata do të manifestojnë mençuri dhe të mos shkaktojnë përçarje, sepse në atë rast do të dëmtohej e gjithë partia. Dhe jo vetëm partia, por edhe procesi politik në Kosovë. Realisht LDK-ja është një parti që ka një traditë, një mision dhe, si e tillë, është e dobishme dhe është në interes të zhvillimit të vlerave demokratike në Kosovë. Si një prej themelueseve të kësaj partie, shpresoj se LDK-ja ta kalojë këtë kuvend në mënyrën e duhur, të dalë me një udhëheqje legjitime dhe pastaj të kontribuojë për proceset e ardhshme demokratike në vend.

demokratike nuk kanë nevojë për kandidat konsensual. Të mërkurën e pashë debatin e Partisë Demokratike në ShBA, ku 20 kandidatë pretendojnë kreun e partisë dhe postin e presidentit. Ishte një debat dramatik në Detroit, ku secili shpaloste aspektet e programit të tij. Besoj se mënyra më e mirë e testimit të demokracisë së brendshme është që të ketë më shumë kandidatë dhe të jetë një garë korrekte, në të cilën mund të fitojë më i miri. Pastaj të gjithë të bashkohen me kandidatin që do të fitojë. Ne tani e pamë rastin e Partisë Konservatore në Britani, në momentin që Johanson fitoi, kundërkandidati i tij ishte i pari që ia uroi detyrën. Por në LDK tanimë është ngulitur një mentalitet i vjetër, i cili nuk do të duhej të ishte. LDK-ja është një parti e vjetër që ka disa vlera demokratike. Kam përshtypjen se me udhëheqjen e fundit të Isa Mustafës ka një kthim prapa në vlerat demokratike në këtë parti.

# LDK-ja pritet të dalë me kandidat konsensual për kryetar të ri

**Prishtinë, 1 gusht (ER)** - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për tri orë rresht ka diskutuar të enjten për përgatitjet e Kuvendit të Nëntë Zgjedhor të saj i cili do të mbahet këtë të shtunë. Në këtë kuvend zgjedhor LDK-ja do ta zgjedhë liderin e vet.

Zëdhënësi i kësaj partie, Besian Mustafa, pas mbledhjes së kryesisë ka bërë me dije se po punohet që në krye të LDK-së të jetë një figurë përbashkuese. Ai ka treguar se në këtë mbledhje është diskutuar për përgatitjet e Kuvendit të Nëntë Zgjedhor, i cili do të mbahet këtë të shtunë. "Kryesia vlerësoi lart interesimin dhe pretendimin për të kandiduar nga disa kolegë në kryesi me kontribute shumë të larta në LDK për 30 vjetët e fundit. Kryesia dhe gjithë anëtarësia e LDK-së vlerëson se është shumë e rëndësishme që në krye të LDK-së të jetë një figurë përbashkuese, për të cilën zgjidhje po punohet intensivisht deri më 3 gusht", ka thënë Mustafa.

Ai ka deklaruar se kryesia e LDK-së ka vendosur që t'i propozojë Kuvendit anëtarët e Komisionit Statutar, Komisionit Verifikues, Komisionit Kandidues, Komisionit Zgjedhor dhe Kryesisë së Punës. Po ashtu, Mustafa ka deklaruar se kandidaturat për kryetar të LDK-së do të shpallen të shtunën.

Deri më tani figurat më të përfolura për kandidat të mundshëm për kryetar të ardhshëm të LDK-së janë Isa Mustafa, Agim Veliu, Fatmir Sejdiu dhe Lutfi Haziri.

Fatmir Sejdiu dhe Lutfi Haziri kanë konfirmuar se do t'i hyjnë garës për kryetar të partisë, kurse Isa Mustafa dhe Agim Veliu nuk kanë dhënë ende një qëndrim nëse do të jenë kandidatë për kryetar të LDK-së.



# Veseli merr pjesë në manifestimin tradicional në Vuthaj

**Plavë, 1 gusht (ER)** - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, njëherësh lider i PDK-së, Kadri Veseli, po qëndron në Plavë e Guci për ndër të manifestimit tradicional që zhvillohet çdo vit në Vuthaj. "Sot mora pjesë në manifestimin tradicional që zhvillohet çdo vit nën hijen e rëndë të bjeshkëve të fshatit Vuthaj. Kosova është veçanërisht mirënjohëse për kontributin e bijve e të bijave të Plavës dhe Gucisë në art, arsim, shkencë, kulturë, shëndetësi, ekonomi, politikë e të gjitha fushat e tjera shoqërore", ka thënë Veseli. Ai ka theksuar se Kosova është veçanërisht mirënjohëse për kontributin e bijve e të bijave të Plavës dhe Gucisë në art, arsim, shkencë, kulturë, shëndetësi, ekonomi, politikë e në të gjitha fushat e tjera shoqërore. "Bashkëkombësve të shumtë të këtij tubimi iu thashë se Kosova ka shumë borxhe ndaj kësaj treve dhe një ndër borxhet më të mëdha që ka është ndërtimi i rrugës Deçan Plavë. Prandaj iu premtova se atë borxh kemi për ta larë shumë shpejt duke përshpejtuar punimet, në mënyrë që ato male që na ndajnë të çahen sa më parë me një tunel, që do të na lidhë si asnjëherë më parë. Po ashtu, i sigurova se sa më shumë të konsolidohet Kosova aq më shumë do të mund t'u vijë në ndihmë vëllezërve dhe motrave nga Plava e Gucia", ka thënë Veseli.






# Naim Bazaj i bashkohet AAK-së

**Prishtinë, 1 gusht (ER)** - Naim Bazaj është bërë pjesë e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Lajmin e ka bërë me dije të enjten lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. "Mikpritje shqiptare, në konakun e familjes patriotike Bazaj të Drenicës. Bujaria dhe atdhedashuria, që e shquajnë tërë Drenicën, janë tipare edhe të Naimit, një nga komandantët e dalluar të ushtrisë sonë çlirimtare, i cili rrugëtimin politik ka vendosur ta vazhdojë me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, së bashku me qindra bashkëveprimtarë të tij, profesionistë të profileve të ndryshme. Faleminderit për mikpritjen dhe besimin në vizionin e Aleancës për shtetin dhe atdheun. Të vërtetë në luftë, ashtu edhe në paqe. Dalshim faqebardhë!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

# Operacion i suksesshëm në QKUK, pacientit i hiqet një cistë në të dyja anët e veshkës

**Prishtinë, 1 gusht (ER)** - Në Klinikën e Kirurgjisë Abdominale të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) mjekët kanë intervenuar te një pacient, duke i hequr një cistë, i shfaqur në të dyja anët e veshkës. Kjo sëmundje është e rrallë në praktikat mjekësore dhe është trajtuar nga një ekip mjekësor, i përbërë nga kirurgë abdominalë dhe urologë, për herë të parë në Kosovë. Operacioni është realizuar me përdorimin e aparaturës bashkëkohore (thika ultrasonike), e cila është vënë në dispozicion të Kirurgjisë Abdominale dhe tashmë është pjesë e punës së përditshme në këtë klinikë. Intervenimi është kryer nga kirurgët e përgjithshëm, dr. Valon Zejnullahu, dr. Salih Krasniqi, dr. Ismet Shaqiri, si dhe urologët dr. Destan Kryeziu, dr. Liridon Selmani, dr. Driton Ferizi dhe dr. Artan Elshani. Ekipi është asistuar nga instrumentaret Xhevrije Jashanica dhe Kumrije Mjaku dhe anesteziologia Sebahate Gashi.



## Filluan punimet në dy projekte infrastrukturore të Skenderajt

**Skenderaj , 1 gusht (ER)** - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit (MIT), Pal Lekaj, të enjten mori pjesë në fillimin e punimeve në rrugën Skenderaj - Vushtrri dhe Kotorr - Qubrel, investime të MIT-it. Ministri Lekaj ka thënë se ndihet mirë që po investohet për përmirësimin e jetës më të mirë të qytetarëve të Skenderajt dhe anekënd Kosovës. Ai ka shuar se pa i zhvilluar komunat e zonat rurale nuk zhvillohet as shteti. Kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, e falënderoi ministrin Lekaj për investimet në projektet e infrastrukturës rrugore në Skenderaj dhe tërë Kosovën pa dallim bindjesh politike sepse këto rrugë u japin qasje shumë fshatrave dhe i lidhin ato me qytetin.

Rruga Skenderaj - Vushtrri është e gjatë afër 14.3 kilometra dhe ka kosto prej 800 mijë eurosh. Ndërsa rruga Kotorr - Qubrel ka gjatësi prej 8.7 kilometrash dhe vlera e saj është 430 mijë euro.



# Vihet gurthemeli i kullës së heroit Rexhep Mala në Hogosht

**Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, e ka konsideruar këtë ditë jashtëzakonisht të rëndësishme për faktin se po nis projekti për dokumentimin dhe vënien në kujtesë të veprimtarisë së Rexhep Malës, Nuhi Berishës dhe bashkëveprimtarëve të tjerë**



EPOKA E RE Qendresa RAMA

KAMENICË, 1 GUSHT - Në Hogosht të Kamenicës është vënë gurthemeli i shtëpisë muze të heroit Rexhep Mala, një objekt ky monumental që do të jetë kujtesë për gjeneratat që do të vijnë për të kaluarën dhe sakrificën që është bërë nga populli shqiptar i Kosovës.

Në një ceremoni të organizuar me këtë rast, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, i shoqëruar nga kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, vunë simbolikisht gurthemelin që nis projektin për ndërtimin e shtëpisë muze të heroit Mala, projekt i cili është bashkëpunim i Ministrisë së Kulturës, komunës së Kamenicës dhe Gjilanit.




Ministri Gashi e konsideroi këtë ditë jashtëzakonisht të rëndësishme për faktin se po nis projekti për dokumentimin dhe vënien në kujtesë të veprimtarisë së Rexhep Malës, Nuhi Berishës dhe bashkëveprimtarëve të tjerë. "Ka qenë përpjekje e vazhdueshme e MKRS-së, por edhe e mekanizmave lokalë dhe e bashkëveprimtarëve të Rexhep Malës, që ta ngrehin këtë shtëpi e cila do të shërbejë si muze për periudhën për të cilën ka vepruar Rexhep Mala", ka thënë ministri, duke u zotuar se do të ngrehet edhe shtëpia muze e Nuhi Berishës. "Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të bëjë përpjekje maksimale që ta sigurojë edhe pjesën tjetër të buxhetit për përfundimin e plotë të ndërtimit të Kullës", ka thënë Gashi.

Ministri Gashi ka folur për aktivitetin patriotik të Rexhep Malës, Nuhi Berishës dhe bashkëveprimtarëve të tjerë gjatë periudhës së viteve të '80-ta të shekullit 20. "Nderim i përmotshëm heroit Rexhep Mala, brezit të tij atdhetar dhe të gjithë të rënëve, dëshmorëve, martirëve të të gjitha epokave të lëvizjes sonë kombëtare, deri në luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila ushtri ishte dhe përjetë do të jetë nderi dhe krenaria e kombit", ka thënë ministri për fund.

Kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrati, tha se monumentet e këtilla ndihmojnë më shumë për të kaluarën e Kosovës. "Sot bashkë bëmë përurimin e kullës së Rexhep Malës shpresoj të rregullohet sa më shpejt dhe të na ndihmojë që gjeneratat e reja mos ta harrojnë asnjëherë sakrificën që jemi tani këtu dhe kombi ynë të zhvillohet përpara", ka thënë ai.

Deputeti i AAK-së Ahmet Isufi, ka thënë se Rexhep Mala ishte nismëtar i luftës për liri dhe se për të ndihet krenare e tërë Kosova. "Sot është ditë e veçantë sepse vihet gurthemeli i një monumenti historik të Rexhep Malës që ra bashkë me Nuhi Berishën. Tani po bëhet një monument që vizitorët ta kujtojnë historinë. Këta persona ishin paralajmëruesit e luftës për liri. Familja është e nderuar dhe krenare që dha birin e vet për lirinë e Kosovës", është shprehur Isufi.

# Këshilli Prokurorial miraton rregulloren për zgjedhjen e kryeprokurorëve

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 GUSHT - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga kryesuesi Bahri Hyseni, ka mbajtur takimin e radhës në të cilin ka shqyrtuar dhe miratuar një sërë çështjesh të rëndësishme. Pas një debati të gjatë, KPK-ja ka miratuar rregulloren për emërimin e kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës, të cilën e ka prezantuar kryesuesi i Komisionit për Çështje Normative, Zejnullah Gashi, rregullore kjo e cila është hartuar në bashkëpunim të plotë me partnerët ndërkombëtarë, shoqërinë civile dhe faktorët e tjerë relevantë, gjë që garanton zbatimin e transparencës dhe meritokracisë, përfshirë edhe respektimin e integritetit dhe profesionalizmit, me ç'rast procesi i emërimit të kryeprokurorëve do të sigurohet me anë të një procedure të pavarur të KPK-së.

Kryetari i Këshillit Prokurorial, Bahri Hyseni, tha se të dy konkurset do të jenë të hapura 15 ditë nga dita prej kur njoftimi del në gazetën shtetërore, e që pritet të ndodhë në shtator. Po ashtu, është marrë vendim për shpalljen e konkursit për emërimin e kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prishtinës, që ka ardhur si rezultat i miratimit të Rregullores për emërimin e kryeprokurorit të shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës.

Ndërsa KPK-ja ka marrë vendim për themelimin e tre paneleve për hetimin e shkeljeve të pretenduarave disiplinore të prokurorëve, me ç'rast shorti i



panelit të parë për caktimin e anëtarëve është tërhequr nga përfaqësuesi i një OJQ-je, praktikë kjo e mirë e zbatimit të transparencës, e cila do të vazhdojë të aplikohet edhe në të ardhmen.

Gjithashtu është aprovuar raporti periodik janar-mars 2019 për veprat penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional, të cilin e ka prezantuar drejtori i Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, Valon Jupa, i cili pasqyron proceset lidhur me nëntë grupet e veprave penale.

Po ashtu, është miratuar kërkesa e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës për transferimin e përkohshëm të një prokurori nga Departamenti i Përgjithshëm i Prokurorisë Themelore të Ferizajt në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, me ç'rast, sipas kërkesës së lartcekur, KPK ka transferuar prokurorin Dushko Manitasheviq.

Në takimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës kanë raportuar edhe kryeprokurorët e të gjitha prokurorive për të arriturat dhe sfidat në gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Gjatë këtij takimi, KPK-ja ka miratuar raportin e komisionit për transferimin dhe avancimin e prokurorëve, ku ka avancuar prokurorin Ismet Tofaj nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Gjakovë. Po ashtu, pas miratimit të raportit të komisionit për transferimin dhe avancimin e prokurorëve, KPK ka bërë transferimin e përhershëm të prokurores Ariana Shajkovci nga Departamenti për të Mitur, në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prizren.

# KRU 'Prishtina', konsumatorëve: Pajisuni me ujëmatës

Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" sh. a. ka apeluar tek të gjithë konsumatorët në zonën që ofron shërbime, se ata të cilët nuk janë të pajisur me ujëmatës, duke filluar nga dita e 1 gusht 2019 deri më 15 gusht 2019 , janë të obliguar t'i vendosin instalojnë (blejnë) ujëmatësit në pronat e tyre, shtëpi, banesa, institucione dhe biznese të vogla dhe të mëdha




**PRISHTINË, 1 GUSHT (ER)** - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" sh. a. ka apeluar tek të gjithë konsumatorët në zonën që ofron shërbime, se ata të cilët nuk janë të pajisur me ujëmatës, duke filluar nga dita e 1 gusht 2019 deri më 15 gusht 2019 , janë të obliguar t'i vendosin instalojnë (blejnë) ujëmatësit në pronat e tyre, shtëpi, banesa, institucione dhe biznese të vogla dhe të mëdha. "Synimi i instalimit të ujëmatësve individualë, aty ku nuk ka, do të reflektojë në reduktimin e humbjeve të ujit dhe rritjen e shërbimeve tona gjithnjë e më cilësore karshi konsumatorit. Pas instalimit të ujëmatësit dhe ofrimit të dëshmisë, KRU 'Prishtina' sh. a. vazhdon tutje procedurat për regjistrimin e ujëmatësit të konsumatorit, me të dhënat e plotësuara si: emri, mbiemri, nr. i letërnjoftimit (apo pasaportës, certifikatës së lindjes). Adresa, sipas emërtimeve të rrugëve nga kuvendi komunal, tel., nr. i ujëmatësit (nëse ka dhe nuk është i regjistruar, duhet regjistruar), kodi (sipas faturës)", thuhet në njoftimin e KRU Prishtina. "Në të kundërtën, KRU Prishtina sh. a. është e detyruar ta bëjë shkyçjen nga ujësjellësi sipas vendimit të dalë nga ARRU-ja, të datës 20. 06. 2019 me nr. protokolli 419/02, mbi eliminimin e faturimit pa ujëmatës, respektivisht mosinstalimin e ujëmatësve apo refuzimin për bashkëpunim", thuhet në njoftimin KUR "Prishtina".



# 'Devolli Corporation', një ndër eksportuesit më të mëdhenj në ShBA

**PRISHTINË, 1 GUSHT (ER)** - Në një ceremoni të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, në prani të shumë të ftuarve, "Devolli Corporation" ka marrë mirënjohje për fuqizimin e raporteve ekonomike ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kosovës në kategorinë e eksportuesve më të mëdhenj të produkteve të Kosovës në ShBA.

"Devolli Corporation", me pronar Shkëlqim Devolli, vazhdimisht ka kontribuar që marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës të thellohen edhe më tepër. Përveç eksporteve të produkteve të ndryshme, dëshmi tjetër është edhe shtrirja e zinxhirit të brendit "Prince Coffee Shop", i cili operon në Bronx, New York. Ky rrjet pritet të zgjerohet së shpejti edhe në vendet e tjera të ShBA-së.

"Devolli Corporation" do të jetë gjithmonë falënderues ndaj angazhimit dhe kontributit të ShBA-së ndaj vendit tonë në përgjithësi dhe komunitetit të biznesit në veçanti.

# KEDS-i: Investimet do ta bëjnë Drenasin 24 orë me energji elektrike

**DRENAS, 1 GUSHT (ER)** - Në kuadër të takimeve të rregullta për zhvillimin e projekteve investive nëpër komuna, zyrtarët e KEDS-it një të tillë e mbajtën në Komunën e Drenasit. "Aty me zyrtarët komunalë u diskutua për sfidat që dalin gjatë realizimit të projekteve dhe për kërkesat dhe nevojat e banorëve në këto anë. Një ndër çështjet që u përfol në takim ishte edhe zhvendosja e shtyllave në hapësirën e stadiumit të ri që po ndërtohet në Drenas dhe lokacionet për vendosjen e trafove. KEDS-i u zotua që do të intervenojë për t'i zgjidhur çështjet e parashtruara në kohën më optimale", thuhet në njoftimin e KEDS-it. "Rreth 30-40 për qind e Komunës së Drenasit po përfshihet në investimet që po bën KEDS-i këtë vit, që kapin koston prej 3 milionë eurove, por KEDS-i po aq ose më shumë buxhet do të investojë edhe në vitin e ardhshëm, që qyteti i Drenasit të ketë 24 orë pandërprerë energji elektrike", ka thënë drejtori i Investimeve në KEDS, Hasan Oz. Kurse drejtori i Infrastrukturës Publike në Komunën e Drenasit, Idriz Hysenaj, u premtoi zyrtarëve të KEDS-it bashkëpunim për ta shtyrë procesin e punës dhe bashkërisht t'ia dalë për një të ardhme më të mirë energjetike për qytetarët e Drenasit.



# Përfaqësues të bizneseve dhe qytetarë kërkojnë përmbajtje nga premtimet elektorale karshi agjendës ekonomike

Përfaqësues të sektorit privat, Berat Rukiqi, Skender Krasniqi dhe Lulzim Syla, kanë kërkuar nga politikanët të jenë të matur gjatë fushatës zgjedhore dhe mos ta zënë në goje rritjen e pagave në sektorin publik dhe rritjen e punësimit. Qytetari Artur Krasniqi, i cili është i punësuar në sektorin privat që nga viti 2010, ka thënë se si rrjedhojë e rritjes së vazhdueshme të pagave në sektorin publik, punëtorët e sektorit privat janë detyruar të heqin dorë nga nevojat elementare në mënyrë që shteti t'ua sigurojë pagat punonjësve shtetërorë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 GUSHT - Përfaqësues të odave dhe asociacioneve ekonomike, Berat Rukiqi nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe Skender Krasniqi nga Oda e Afarizmit të Kosovës, si dhe njohësi i çështjeve të biznesit, Lulzim Krasniqi, tanimë kur jemi në prag të shpërbërjes së qeverisë Haradinaj në detyrë, kanë kërkuar nga spektri politik që të përmbahen nga premtimet "megalomane" për fushatë parazgjedhore e që, sipas tyre, shkojnë në kurriz të ngarkesës financiare për bizneset, por edhe punëtorët e sektorit privat. Sipas tyre, spektri politik duhet të jetë i matur dhe mos të premtojë rritje pagash në sektorin publik, rritje të punësimit, tërheqje të investimeve të huaja, ndalje të ikjes së trurit "brain drain", si dhe lëvizje të lirë të qytetarëve dhe bizneseve.

Kryetari i Odës së Afarizmit të Kosovës, Skender Krasniqi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se rritja e pagave dhe rritja e punësimit s'do të duhej që të ishin në agjendën e premtimeve elektorale. "Në çdo shtet normal në botë prioritet i tyre është rritja e punësimit, e që më pas do të përcillej edhe me rritjen e pagave, kurse tek ne prioritet është rritja e pagave në sektorin shtetëror. Shihni çdo vit në tregun e punës hyjnë 30 mijë qytetarë, kurse në vitin e kaluar, karshi vitit 2017, kishim 10 mijë vende më pak të punës. Andaj, kur bëhet rritja e pagave duhet t'i dallojmë në bazë të viteve të shkollimit, e jo të marrë pagë të njëjtë si ai me shkollë të mesme si ai me fakultet. Rritja e pagave çdoherë është premtuar dhe bërë në sektorin publik, e që barrën për këtë e kanë vënë te bizneset dhe punëtorët e sektorit privat. Do të duhej të ndalej kjo praktikë", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se s'mund të thirrën edhe në respektim të Ligjit të Punës, pasi ka mos[përputhje në mes të orëve të punës. "Respektimi i Ligjit të Punës që në letër shënon 40 orë pune në javë, në institucionet publike punohet vetëm 35 orë, prandaj duhet të jenë të saktë edhe në këtë drejtim. Po ashtu, kemi shumë udhëzime administrative që s'u përfillën e që do të kontribuonin në zhvillimin ekonomik. Zhvillimi ekonomik, zhvillimi i turizmit dhe prodhimtaria çdoherë ishin tema, por vetëm deklarata gojore", u shpreh Krasniqi.

Edhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukqi, ka apeluar te lidershipi që të jetë i matur dhe mos të japë premtime sa për vota. Ai ka kërkuar përmbajtje nga premtimet të cilat janë të parealizueshme dhe pa një analizë të mirëfilltë e që, sipas tij, e rëndojnë edhe sektorin privat. "Assesi mos të ketë premtime për hapje të vendeve të punës kur s'ka qartësi se si mund të hapen. Mos të ketë premtime për rritje pagash, sidomos në sektorin publik dhe premtime për tërheqje të investimeve, që shpesh aludojnë në mrekulli. Në kohë fushatash ka eufori dhe shpesh s'përfillet legjislativi i Kosovës", u shpreh ai. Sipas Rukqit, ideale do të ishte që spektri politik të dalë në fushatë elektorale me një marrëveshje politike karshi agjendës ekonomike. "Ideale do të ishte të kishte një pakt të partive politike, që mos të bëjnë asnjë premtim në fushatë zgjedhore gjatë punës së tyre në qeveri dhe kuvend që s'ka rezultate dhe dëmton qëndrueshmërinë financiare të shtetit, por edhe realisht bëhen edhe pengesë për zhvillimin e sektorit privat", u shpreh Rukqi.

Po ashtu, i së njëjtës linjë të apelit është edhe njohësi i çështjeve të biznesit në vend, Lulzim Syla. "Apeloj që mos të dalim me premtime të rritjes së punësimit me shifra për të cilat s'kanë asnjë plan konkret, e që mbi bazë të punësimit do të ngrehej edhe zhvillimi ekonomik. Po ashtu, as rritja e pagave s'do të duhej të ishte premtim i programit të tyre, duke përfshirë këtu edhe liberalizimin e vizave që s'do të duhej hiç ta përmendnin, pasi s'kishin gatishmërinë më të vogël për të dhënë një datë të saktë. Po ashtu, mos të thirrën as në cilësinë në arsim që, si rrjedhojë, ka çuar edhe në falimentime, pasi në momentin që s'ke njerëz të edukimit të mirëfilltë, ke konkurrencë të ashpër, e që mandej të dërgon edhe në falimentim", u shpreh Syla.

Edhe qytetari Artur Krasniqi, i cili është i punësuar në sektorin privat që nga viti 2010, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se punëtorët e sektorit privat duhet të heqin dorë nga nevojat elementare që shteti t'i sigurojë pagat për punëtorët e sektorit publik e që, sipas tij, kjo s'mund të jetë zhvillim, por mjerim. "Tanimë u bënë hite premtimet e njëjta, por vendi zhvillohet kur ka infrastrukturë të mirëfilltë ligjore. Andaj, vetëm punësimet në sektorin publik s'janë zhvillim, por mjerim për shoqërinë. Rritja e pagave vetëm në sektorin publik pa dyshim se ndikon në mirëqenien e punëtorëve të sektorit privat dhe ne duhet të sakrifikojmë shumë për nevojat tona elementare, e mos t'i përmendim ato të luksit, në mënyrë që atyre shteti t'ua sigurojë pagat, apo rritjen e tyre. Rritja e mëtutjeshme e pagave të tyre s'mund të mbrohet apo arsyetohet nga asnjë qeveri", u shpreh Krasniqi.



## Punimet në ndërtimin e objektit të çerdhes në lagjen 'Kalabria' përfundojnë në tetor



PRISHTINË, 1 GUSHT (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se punimet për ndërtimin e objektit të çerdhes me bazë në komunitet në lagjen "Kalabria" po zhvillohen sipas planit dinamik. Dhe sipas këtij plani, punimet pritet të përfundojnë në muajin tetor. Kjo çerdhe është e financuar nga Bashkimi Evropian dhe ka kapacitet për akomodimin e 100 fëmijëve të kësaj lagjeje. "Investimi në edukimin e hershëm është vendimi më i duhur për të siguruar një ardhme më të mirë për fëmijët tanë dhe për të siguruar një shoqëri të shëndoshë. Ndërsa modeli i çerdheve me bazë në komunitet është mënyra më e mirë e gjithëpërfshirjes së prindërve në edukimin e fëmijëve", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.

# Hapet Panairi Artizanal në Malishevë



MALISHEVË, 1 GUSHT (ER) - Në kuadër të shënimit të ditëve të mërgatës dhe në prag të fillimit të Festivalit Folklorik "Oda e Llapushës", që filloi të enjten, në Malishevë është hapur edhe Panairi Artizanal, në të cilin po prezantohen veshjet dhe ushqimet tradicionale shqiptare nga të gjitha trevat.
Panairi artizanal tashmë është tradicional në Malishevë dhe mbahet çdo vit më 1 dhe 2 gusht. Panairi ka për qëllim promovimin e vlerave të traditës shqiptare si në veshje, po ashtu edhe në gatime, apo në ruajtjen e perimeve (turshi), mjaltë dhe të tjera e, po ashtu, në këtë panair po prezantohen edhe vendet turistike të Malishevës, përmes fletushkave të përgatitura nga OJQ-të lokale. "Në këtë panair, sidomos mërgimtarët dhe të rinjtë, kanë mundësi të njihen me traditat dhe trashëgiminë shqiptare si në veshje, po ashtu edhe në ushqime tradicionale shqiptare, në mënyrë që të kultivohet kultura jonë e lashtë shqiptare me të cilën ne krenohemi", ka thënë Besa Kryeziu - Ramaj, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, me rastin e hapjes së panairit.
Panairi do të qëndrojë hapur për dy ditë, aq sa edhe zgjatë festivali.

# Gjilani aktivizon të gjitha shërbimet në shëndetësinë primare



GJILAN, 1 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka bërë nënshkrimin e marrëveshjes trevjeçare me Caritas Kosova për mbështetjen e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Gjilan, duke bërë kështu aktivizimin e shërbimeve shtesë në sektorin primar të shëndetësisë me qëllim të ofrimit të shërbimeve në sektorët e mjekësisë familjare, infermierisë, stomatologjisë, laboratorit, patronazhit, aktivizimin e të gjitha punkteve të Gjilanit dhe shërbime të tjera të emergjencës.
Në fjalën e tij pas nënshkrimit të marrëveshjes, kryetari Haziri ka thënë se arsimi dhe shëndetësia janë dy sektorët prioritarë në përkujdesjen e qeverisjes komunale dhe për shërbime me kualitet të lartë profesional dhe shtim të dinamikës së punës, por edhe të shërbimeve. "Komuna e Gjilanit ka bërë zgjidhje për tre vjetët e ardhshëm. Do të angazhohen 30 profesionistë si staf shtesë dhe mjekë, stomatologë dhe infermierë të rinj, që do t'i mbulojnë shërbimet e patronazhit, shërbimet e emergjencës, hapjen e zyrës së nutricistes në QKMF si dhe mbështetje teknike dhe mjekësore për QKMF-në në Gjilan", ka thënë kryetari Haziri.
Ndërsa drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Selami Xhemajli dhe drejtori i QKMF-së, Fejzulla Berisha, kanë thënë se me mbështetjen e kryetarit Haziri, po krijohen lehtësira në funksionimin e shëndetësisë primare në Gjilan.
Kontrata me Caritasin është trevjeçare dhe do të mundësojë që, përpos kuadrove të reja me mjete vetjake, të investojë edhe në blerjen e dy autoambulancave për shërbimin e Urgjencës në kuadër të QKMF-së, pastaj furnizimin me tensiometra statikë, tensiometra dore, stetoskop, otooftalmoskop statik, otoskop dore, inhalator, EKG, monitor për përcjelljen e shenjave vitale të pacientit, pulsoksimeter, drita për ekzaminimin e fytit, çanta për terapi për urgjencë dhe për shërbime të tjera në terren.

## Muharremaj u bënë thirrje qytetarëve të Suharekës të mos përdorin armë gjatë ahengjeve familjare



SUHAREKË, 1 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka zhvilluar një takim me përfaqësuesit regjionalë të policisë nga Prizreni, me drejtorin rajonal kolonel Faton Alija dhe nga stafi nënkolonel Musli Kololli dhe toger Shaban Osmanollaj.
Muharremaj ka bërë me dije se është informuar se janë shtuar masat e sigurisë dhe sipas statistikave ka rënie të dukurive negative. "Kam ofruar bashkëpunim në kuadër të suazave ligjore si në mbrojtjen e pyjeve, lirimin e parkingjeve dhe të hapësirave publike. Po ashtu, jam njoftuar se ka masa të sigurisë edhe në ahengje familjare të cilat janë të shumta në këtë sezon dhe apelohet që qytetarët të mos përdorin armët gjatë festave. I ftoj të gjithë që të respektohen rendi dhe ligji. Bashkë mund ta bëjmë vendin tonë më të sigurt", ka thënë kryetari Muharremaj pas takimit.

Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (8)

# ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

## - Përshtypjet në "librin e zisë"



Përgatiti: Selatin NOVOSELLA

Me respekt i madhi Baca Adem Demaçi! Lavdi!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Lavdi jetës dhe veprës madhështore të Adem Demaçit!

27 korrik 2018,
Rinia e PDK, Lipjan

Luan ishe në këtë jetë, na mësove të bëhemi të tillë! Legjendë do jesh deri në amshim!

27 korrik 2018,
Fahri Zebica

Lavdi Bacës, me faqe të bardhë!

27 korrik 2018,
D. M.

Përjetësisht LAVDI, njeriut, që shkriu çdo gjë si qiriu, për atdheun e tij, Kosovën!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Lavdi, Bacës Adem!
Bacë, nuk je vdekur, bacë të shtrëngova dorën herët në Cyrih të Zvicrës, Bacë, të shtrëngova dorën edhe në Gostivar, atje ku bashkërisht me Gostivarasit NDEZE FLAUTËN E JANARIT! Bacë, edhe sot qëndroj gatitu, për të marrë detyrat e reja...!
Lavdi o Bacë!

27 korrik 2018,
Luan Veliu, Gostivar

Lavdi Baca Adem!
Gjithmonë qofsh në zemrat tona! Do jetësh përherë me ne!

27 korrik 2018,
Ceni, Gostivar

Lavdi e respekt Baci Adem! Do nderohesh përherë nga çdo atdhetar shqiptar, kudo që jeton.

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem, nuk kemi me të harrua asnjëherë! Lavdi!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Rilindësi i Shekullit të bashkimit kombëtar, i idealizmit, revolucionari i paepur! I tillë ishte Baca Adem Demçi.

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Lavdi të pavdekshmit, Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Shemsedin Hoxha

Lavdi të pavdekshmit, Bacës Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Ismajl Rashiti

Jam me fat që jetova në Epokën Tënde! Lavdi jetës dhe veprës se Kolosit, Bacës, Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Afrim Termkolli

Lavdi e përjetshme strategut dhe kolosit shqiptar, Bacës Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Sabri Rexha

Lavdi heroit, Nderit të Kombit, bacës Adem!

27 korrik 2018,
Elfete Rexhepi

Në mes të dy jetëve, zgjodhe jetën e përtejme! Ishe shembull se si luftohet e rezistohet për liri r demokraci. Këtë jetë ia fale kombit me sakrificë sublime, kurse tjetrën uroj t'ia falësh Zotit të parajsës!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem, Ti ike dhe fizikisht nuk do të jesh në mesin tonë, por sakrifica, vepra dhe vizioni yt do të jenë gjithmonë udhërrëfyes për brezat e ardhshëm, do të jenë model se si duhet ta duam atdheun dhe si duhet të sakrifikohemi si popull për atdhe.
I lehtë të qoftë dheu i Kosovës! Lavdi!

27 korrik 2018,
Rexhep Tërshnjaku

Lavdi veprës dhe jetës së Adem Demaçit!

27 korrik 2018,
Nazmije (mbiemri i palexueshëm)

Krenar që të patëm, keq që të humbëm! Vepra jote është pavdekësi o Baca Adem Demaçi!

27 korrik 208,
E. Fetahu

Ti ishe dhe do të jesh "Baba i Kombit"! lavdi për punën dhe veprën Tënde!

27 korrik 2018,
Sejdi Lahu

Lavdi e përjetshme o burrë i madh i kombit, Hero i Kosovës! Ti Bacë dhe gjithçka nga vetja që vetëm të rrojë Kombi Shqiptar!

27 korrik 2018,
Ali Mehmeti, Besianë

I përjetshëm do të mbetet kujtimi për Ty Bacë! Vepruam dhe punuam me emrin Tënd deri në çlirim! Faleminderit për gjithçka dhe për kombin tonë!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Me fat është çdo njeri që jeton në planetin ku frymove Ti. Ne ishim me shumë fat. Zoti të shpërbleftë me të mirat e TIJ!

27 korrik 2018,
Besnik Berisha

Lavdi, Baca Adem!

27 korrik 2018,
Mehdi Sinani

Të mëdhenjtë nuk vdesin, ata vetëm ndërrojnë jetë. Lavdi, Bacë, Biri i Kombit!

27 korrik 2018,
Ramush Sinani

Në emër të familjes së Gjeneralit Shaban Shala, shprehim ngushëllimet më të sinqerta familjes së Legjendës së Kombit shqiptar, Adem Demaçit. Lavdi!

27 korrik 2018,
Elmi, Gani e Nuhi Shala

Lavdi veprës së Heroit tonë Kombëtar, Adem Demaçi! Ishim një grup njerëzish nga Reçaku për të nderuar veprën e madhe dhe të palodhur të Bacës Adem! Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës!

27 korrik 2018,
Afrim Jakupi me shokë, Reçak

Lavdi për jetë e mot, Bacë! Mburremi që të patëm!

27 korrik 2018,
Besim Dinolli, Pleshinë

Do të mbetesh shembull për shumë gjenerata të reja anë e mbanë tokave shqiptare! Lavdi!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

I përjetshëm qoftë kujtimi për Ty Daja im i dashur!

27 korrik 2018,
F. Tetovë



Lavdi o njeri i madh Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

I përjetshëm qoftë kujtimi për Ty, Daja Adem! Do të më mungosh! Me respekt përherë!

27 korrik 2018,
Nipi i Juaj

Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës, Daja Adem! Vepra dhe sakrifica jote nuk vdes kurrë! Lavdi!

27 korrik 2018,
Zgjim Shaini

Respekt të veçantë për Bacën, Adem Demaçi! Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës të cilën e deshe aq shumë!

27 korrik 2018,
Mifail Xhemajli

Ngushëllime Kombit Shqiptar... Baca Adem do të frymojë i gjallë sa të ketë jetë në trojet tona shqiptare!

27 korrik 2018,
Ilmije Ali Rexha

Ishe dhe mbetesh frymëzues brezash! Një në kombin shqiptar, shembull për njerëzimin!

27 korrik 2018,
Jeton A. Rexha

Lavdi jetës dhe veprës së pavdekshme të Bacës Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Agim (mbiemri i palexueshëm)

Ngushëllimet më të thella nga zemra për Bacën Adem, luftëtarin monumental të çështjes kombëtare dhe simbolin e lirisë dhe të qëndresës kombëtare, kolosin e kombit, të virtyteve dhe vlerave universale!

27 korrik 2018,
Naim Zymberi

Ngushëllime familjes së madhe DEMAÇI! Veprat e Tij janë të pavdekshme për ne të gjithë shqiptarëve të Kosovës! I qoftë i lehtë dheu i Kosovës për të cilën e sakrifikoi tërë rininë e vet!

27 korrik 2018,
Nexhmije Gecaj, Prapashtica

Ngushëllime për familjen dhe të afërmit, për njeriun që një e jetë e sakrifikoi për lirinë e vendit dhe të popullit të tij, dhe për fat e priti lirinë! Vepra jote s'mund të harrohet!

27 korrik 2018,
(emri i palexueshëm) Gecaj

E adhuroja pa masë Skënderbeun, Gjyzepe Garibaldin, Ymer Prizrenin, që punuan për bashkimin Kombëtar!
Ti ndoqe rrugën e tyre dhe na le amanet të punojmë deri në Bashkimin Kombëtar!

27 korrik 2018,
Jakup Mazreku, Malishevë

**(Vazhdon në numrin e ardhshëm)**

## BE-ja thotë se marrëveshja për Brexit nuk rihapet



**Bruksel, 1 gusht** - Bashkimi Evropian i tha këshilltarit të ri britanik për Evropën se nuk është i gatshëm të rinegociojë marrëveshjen për Brexit, apo daljen e Britanisë nga BE-ja.
Zëdhënësja e Komisionit Evropian, Mina Andreeva, tha se këshilltari David Frost zhvilloi të mërkurën dhe të enjten takime me zyrtarë të lartë të Komisionit Evropian, i cili administron negociatat për Brexit-in në emër të vendeve anëtare të BE-së.
Andreeva tha se "të dyja palët i përsëritën qëndrimet e tyre dhe se marrëveshja për Brexit nuk është për rihapje".
Andreeva po ashtu tha se kryeministri britanik, Boris Johnson, dhe presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, "do të kenë rastin" të flasin për Brexit-in në Francë, më 24-26 gusht, në margjina të një samiti të G7-ës, apo grupit të vendeve më të industrializuara.
Këtë javë, Johnson tha se do të bisedojë me udhëheqësit e BE-së për Brexit-in kur ata t'i ndryshojnë qëndrimet për marrëveshjen e divorcit.
Në të kundërtën, Britania do të përgatitet të dalë nga blloku pa marrëveshje, tha zëdhënësja e Johnsonit.
Britania ka arritur marrëveshje me BE-në mbi kushtet e divorcit nëntorin e kaluar, pas dy vjetësh negociata.
Por, ajo është refuzuar tri herë nga Parlamenti britanik, kryesisht për shkak të politikave në kufirin me Irlandën Veriore, çfarë ka çuar edhe në dorëheqjen e kryeministres së deritashme britanike, Theresa May.

# Brexit-i dhe aleanca ShBA-Britani

**Pasi që paundi britanik ka pësuar rënie të ndjeshme dhe mund të shkaktojë kaos ekonomik, kryeministri Johnson ka shpresa se do të gjejë mbështetje tek aleati i fuqishëm në Shtëpinë e Bardhë për ta ndihmuar në këtë proces**



**Londër, 1 gusht** - Mundësia që Britania të shkëputet në fund të tetorit në mënyrë të pakontrolluar nga Bashkimi Evropian, pa pasur një udhëzues paraprak në formën e një marrëveshjeje dypalëshe, ka krijuar një situatë të trazuar politike për kryeministrin e ri britanik, Boris Johnson. Paundi britanik ka pësuar rënie të ndjeshme dhe analistët paralajmërojnë se mund të ketë kaos ekonomik. Johnson ka shpresa se do të gjejë mbështetje tek aleati i fuqishëm në Shtëpinë e Bardhë për ta ndihmuar në këtë proces.
Presidenti amerikan i përcolli urime të ngrohta kryeministrit britanik kur mori detyrën:
"Mendoj se mund të kemi një marrëdhënie të shkëlqyer", tha presidenti Trump.
Sidomos në tregti mund të realizojnë 3-4 herë më shumë shkëmbime tregtare sesa tani", tha ai.
Këto janë premtime të mirëpritura për kreun e Qeverisë britanike në një kohë që vendi përballet me rrezikun e një shkëputjeje të pakontrolluar nga Bashkimi Evropian, nëse nuk arrihet më parë një marrëveshje. Prandaj kryeministri Johnson i ka varur shpresat te Shtetet e Bashkuara për mbështetje, ka njoftuar voa.
"Shtetet e Bashkuara janë, kanë qenë dhe do të jenë për një të ardhme të parashikueshme, aleati, miku dhe partneri ynë numër një", tha Johnson.
Ishte një mesazh në adresë të Amerikës dhe Evropës.
"Nëse Qeveria britanike arrin të negociojë një marrëveshje të mirë me Shtetet e Bashkuara, ajo shpreson që kjo do t'i rriste pikë kur të ulet me evropianët për të negociuar", thotë profesori Tim Oliver.
Ata që e mbështesin këtë ide i kanë varur shpresat te simpatia që kanë dy udhëheqësit për njeri-tjetrin.
"Ata të dy kanë plot pika të përbashkëta; jo thjesht flokë të verdhë, por edhe natyrën impulsive si dhe personalitete që bëhen më të spikatura se politikat që ndjekin. Po ashtu të dy kanë kufizime të ngjashme kushtetuese", thotë profesori Oliver.
Johnson ka një shumicë shumë të vogël në parlament.
Në Shtetet e Bashkuara, demokratët kontrollojnë Dhomën e Përfaqësuesve dhe janë betuar t'i përmbahen Marrëveshjes së të Premtes së Mirë që mundësoi ndalimin e konfliktit në Irlandën e Veriut.
"Nancy Pelosy dhe demokratët në Kongres e kanë thënë shumë qartë se nëse vendoset kufi me Irlandën, Britania nuk do të sigurojë dot marrëveshje tregtare me Shtetet e Bashkuara", thotë John Springworth i Qendrës për Reforma Evropiane.
Përveç Brexit-it, Britania ndeshet aktualisht me plot sfida të tjera. Irani mori nën kontroll para disa javësh një cisternë detare që lundronte nën flamurin britanik dhe po vazhdon procesin e pasurimit të materialeve bërthamore. Uashingtoni shpreson që Britania do të ndjekë shembullin e tij dhe do të braktisë marrëveshjen me Iranin.
Në Hong Kong, protestuesit prodemokracisë akuzojnë Britaninë, dikur kolonizuese e këtij ishulli, se tani u ka kthyer shpinën dhe i ka lënë në dorë të Kinës.
"Ka një numër temash që mund t'i acarojnë marrëdhëniet ShBA-Britani: Irani, Kina, ndryshimet klimatike, tortura… ka plot", thotë profesor Oliver.
Në Evropë ka plot që mendojnë se Brexit-i po dëmton sigurinë.
"Nga pikëpamja gjeopolitike ata shqetësohen se ndodhemi përballë një periudhe të përçarjeve brenda Perëndimit, ndërkohë që Rusia po ndjek politika revanshiste. Këto zhvillime po sjellin probleme jo vetëm në Britani, por edhe në Shtetet e Bashkuara dhe brenda Bashkimit Evropian. Ndërkohë Kina po shfaqet me forcë më të madhe në arenën ndërkombëtare", thotë Springworth.
Boris Johnson ka folur për një epokë të artë që po lind, një koment që të kujton zotimet e presidentit Trump për ta bërë Amerikën përsëri të madhërishme. Por ndërkohë që mbeten rreth tre muaj deri në momentin e shkëputjes së Britanisë nga BE-ja, ky vizion optimist mund të mbytet së shpejti nën një mori problemesh të pakontrollueshme.

## Kelly Craft, ambasadore e ShBA-në në OKB



**Uashington, 1 gusht** - Senati amerikan me 100 ulëse ka miratuar propozimin për të emëruar Kelly Craftin si ambasadore të re të Shteteve të Bashkuara në Kombet e Bashkuara.
Craft është kthyer në donatoren e parë të madhe politike që ka zënë një post të lartë në OKB.
Ish-ambasadorja e Shteteve të Bashkuara në Kanada, Craft dhe burri i saj, Joe Craft, një miliarder, kanë financuar Partinë Republikane dhe presidentin amerikan, Donald Trump që ka emëruar atë.
Ajo, po ashtu, njihet edhe si aktiviste e Partisë Republikane nga Kentaki.
Emërimi saj është përcjellë me disa ankesa nga demokratët, pasi disa prej tyre e kanë konsideruar të papërvojë për atë pozitë.
Ajo do të zëvendësojë Nikki Haleyn, e cila ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë në muajin dhjetor të vitit 2018.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

E jashtëzakonshme

# I shpëtoi jetën, pitoni e "përqafon" për vdekje



Një roje pylli në Indi shpëtoi për mrekulli pasi një piton i madh u përpoq që ta mbyste pasi roja i kishte shpëtuar pak më parë jetën atij. Kur po pozonte për një foto me pitonin, gjarpri 10 metra i gjatë nisi t'i mblidhej rreth qafës rojës indian. Në këtë çast rojën e zuri paniku dhe nisi të vraponte duke u munduar që ta lironte "përqafimin" e pitonit, ndërkohë që ndërhynë dhe kolegët e tij për ta "zbërthyer" pitonin.

FOTO E DITES




Ky imazh ajror tregon anijet peshkimi në ditën e fundit të moratoriumit të peshkimit veror në provincën Jiangsu të Kinës. Fotografia: AFP, publikuar në Zërin e Amerikës.

E rrallë

# Turisti i dehur thyen rregullat për një xhiro me gjirafë



Një vizitor i dehur në kopshtin zoologjik në Kazakistan është përpjekur të bëjë xhiro me gjirafë. Në rrjetet sociale po qarkullojnë pamjet ku burri shihet duke kaluar gardhin e sigurisë dhe duke hipur në qafën e gjirafës. Nuk ia doli të qëndronte gjatë në qafë dhe përfundoi në shpinë por, me disa lëvizje të kafshës, burri u rrëzua në tokë. Thuhet se nuk ka pësuar lëndime. Ndërkohë policia është në kërkim të tij pasi ka bërë një veprim të ndaluar dhe do të merren masa për të.

## BARSOLETA E DITËS



**Plaku mbush 90 vjet, shqiptarët komentojnë: Edhe 100 vjet të tjera të lumtura!**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Çdo ditë në ora 15:30**

## "Spider-Man Far From Home" 3D,



Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min

Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts




**Çdo ditë në ora 17:30**

## "THE LION KING" 3D

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

**Rolet:** Donald Glover,Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyonce Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver

**Regjia:** Jon Favreau

**Në ora 19:30 dhe 22:00**

## "HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

**Rolet:** Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.

**Regjia:** David Leitchu







**Nga dt. 08.08.2019**

## "THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

**Regjia:** Thurop Van Orman

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI** Nëse doni ta rrisni vetëbesimin e dikujt, është mirë ta merrni dhe të diskutoni me të me qetësi për ngjarjet e fundit që i kanë ndodhur.



**DEMI** Sot do të rriteni shpirtërisht duke dëgjuar muzikë të mirë dhe duke ndenjur në ambiente intelektuale që kishin kohë që ju mungonin.



**BINJAKËT** Nëse keni marrë përsipër të përshkoni një rrugë të caktuar nuk duhet të keni më mëdyshje. Çdo kthim pas do t'ju kushtojë.



GAFORRJA Shumë objektiva tuajat po i anashkaloni vetëm për një hutim të çastit. Do të jetë më mirë të kërkoni këshilla te personat e duhur.



**LUANI** Po ju jepen shumë mundësi në karrierë dhe jeni të dyzuar ndërmjet oportuniteteve që do të zgjidhni. Kërkoni mendimin e familjes.



VIRGJËRESHA Çdo gjë po shkon më së miri nga ana sentimentale. Ju ndiheni në qiellin e shtatë nga një dhuratë që jua ka bërë partneri.



PESHORJA Momenti më i mirë i ditës suaj është mëngjesi. Keni kohë të mendoni për çdo gjë dhe jeni më produktiv dhe energjik.



**AKREPI** Duhet t'i shfrytëzoni informacionet e reja që do të merrni dhe nuk keni pse merrni kohë që të mendoheni. Çdo gjë ka për të shkuar siç e keni vendosur.



SHIGJETARI Sot po reflektoni mbi çështje që më parë ju janë dukur shumë të thjeshta. Keni anashkaluar gjëra të rëndësishme që tashmë janë bërë probleme.



BRICJAPI U bë disa kohë që një person i caktuar po ju bezdis lidhur me një temë që ju nuk dëshironi ta prekni. Sot do të tregoheni shumë i prerë.



**UJORI** Sot do të keni surpriza pozitive dhe negative. Keni lënë për shumë kohë pezull një situatë që tashmë ka degjeneruar.



PESHQIT Edhe pse në ambientin e punës mund të keni probleme të vogla, personat që ju rrethojnë, nuk kanë qëllime negative karshi jush.

# Zbulohet zyrtarisht shkaku i vdekjes së Cameron Boyce



Shkaku i vdekjes së Cameron Boyce është konfirmuar zyrtarisht. Ylli 20-vjeçar vdiq për shkak të një konfiskimi masiv epileptik, sipas "The Blast". Vdekja e tij e papritur u lidh me epilepsinë, sipas policisë. Ai ishte diagnostikuar tre vjet më parë dhe tashmë kishte pësuar konfiskime të mëdha ndër vite. Thuhet se ai po merrte Keppra për t'u trajtuar. Cameron u gjet i vdekur më 6 korrik në shtëpinë e vet në Los Anxhelos.

# Catherine Zeta Jones dhe Michael Douglas, për pushime në Evropë



Catherine Zeta Jones dhe Michael Douglas po shijojnë ca ditë pushimi jashtë shtetit të tyre. Aktorja 49-vjeçare dhe aktori 74-vjeçar u panë dorë për dore duke zbritur nga një varkë, ndërsa arritën në një restorant në Portofino, Itali. Një ditë më parë çifti ishte në Francë. Muajin e kaluar Catherine Zeta Jones dhe Michael Douglas ishin pjesë e 'Enigma's Show' të Lady Gaga në Nju Jork.



# Kerry Katona në gjyq për shkak se nuk dërgoi fëmijën në shkollë

Kerry Katona do të gjykohet pasi dyshohet se nuk e ka dërguar në shkollë njërin prej fëmijëve. Këngëtarja britanike është akuzuar se nga 31 tetori deri më 28 nëntor të vitit të kaluar nuk e ka dërguar fëmijën në mësime, shkruajnë mediat e huaja. 38-vjeçarja ka mohuar akuzat e ngritura ndaj saj. Asaj i është thënë se në tetor të këtij viti do të përballet me gjykatën. Mbrojtësi ligjor i saj, Jason La Corbiniere, ka thënë se nuk bëhet fjalë për ndonjë ngatërresë me këngëtares dhe fëmijës, por që nuk ka mundur ta dërgojë atë në shkollë për shkak të sëmundjes.

# Lena Dunham shfrytëzon rastin dhe puth Brad Pittin



Lena Dunham ka thënë se ka filtruar me yllin Brad Pitt në grupin e Quentin Tarantino në filmin "Once Upon a Time in Hollywood", por krijuesi i "Girls" i ka çuar gjërat në tjetër nivel gjatë premierës së filmit në Londër. Kur kasta u rreshtua në tapetin e kuq, Dunham u nda prej Pittit nga Tarantino dhe yjet e famshëm Leo DiCaprio dhe Margot Robbie. Por ajo sërish arriti te Brad dhe i dha një puthje në buzë. Në film ajo luan një ndjekëse të Charles Mansonit.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# FFK-ja kërkon nga FIFA dhe UEFA ndalimin e garave ilegale në Kosovë

Federata e Futbollit e Kosovës ka kërkuar menjëherë nga FIFA dhe UEFA që t'i ndalojnë garat ilegale të futbollit në territorin e Kosovës. "FIFA dhe UEFA duhet ta ndalojnë menjëherë Federatën e Futbollit të Serbisë që të mos i përfshijë klubet nga Kosova në garat e organizuara nga federata serbe", thuhet në letrën e FFK-së




EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 1 GUSHT - Organizimi i ndeshjeve zyrtare dhe kupave nga klubet serbe brenda territorit të Kosovës është i patolerueshëm për Federatën e Futbollit të Kosovës. Numri një i FFK-së, Agim Ademi, të enjten i ka shkruar letër presidentit të FIFA-s, Gianni Infantino dhe presidentit të UEFA-s, Aleksander Ceferin, ku ka kërkuar të merren masa ndaj Federatës së Futbollit të Serbisë, pasi një gjë e tillë nuk do të lejohet nga institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës. "Në vazhdimësi shumë herë dhe për herë të fundit muajin e kaluar, ne e kemi adresuar në UEFA dhe FIFA shqetësimin tonë në lidhje me organizimin e një lige zyrtare dhe ndeshjeve të kupave nga klubet serbe brenda territorit të Kosovës. Situata do të eskalojë pasi që klubi nga Kosova, Trepça, do të garojë në Ligën e Tretë të Serbisë, gjë e cila nuk do të tolerohet nga qeveria, policia dhe zyrtarët e tjerë shtetërorë", thuhet në letrën e Federatës së Futbollit të Kosovës.

Në letrën reaguese është përmendur edhe pengimi i lojtarëve dhe trajnerit serb që mos të paraqiten në ndeshjen në mes Malit të Zi dhe Kosovës si dhe në ndeshjen e Ligës së Evropës ku lojtarët e Slovan Bratislavës nuk u lejuan të luajnë ndaj Feronikelit. "Për më tepër, ne prisnim më shumë mirëkuptim dhe konsideratë nga Federata e Futbollit e Serbisë, por duket se ata janë plotësisht të kontrolluar dhe të ndikuar politikisht. Moslejimi i lojtarëve dhe trajnerit serb të Malit të Zi të luajnë kundër Kombëtares së Kosovës dhe, së fundi, lojtarëve të Slovan Bratislavas kundër kampionit tonë, Feronikelit, është tregues i urrejtjes së thellë dhe humbjes së realitetit nga qeveria serbe", thuhet në reagimin e FFK-së. "Nëse FIFA dhe UEFA nuk ndërhyjnë dhe shfaqin vendosmëri, futbolli do të shkaktojë edhe më shumë konflikt politik, që do të ishte i paprecedent dhe dëmtues ndaj shtëpive tona të futbollit. FIFA dhe UEFA duhet ta ndalojnë menjëherë Federatën e Futbollit të Serbisë që të mos i përfshijë klubet nga Kosova në garat e organizuara nga federata serbe. Për më tepër, ne kërkojmë nga UEFA të ndërhyjë ndaj Federatës së Futbollit të Serbisë për t'i bërë ndryshimet e nevojshme në statutin e tyre, ku Kosova është pjesë e shoqatës së tyre, që është e papranueshme dhe në kundërshtim me të vërtetën dhe statutet e FIFA-s dhe UEFA-s", përfundon reagimi i FFK-së për FIFA-n dhe UEFA-n.

## SHKURT

### Muçaj prezantohet te Vushtrria

Futbollisti nga Shqipëria, Ledjon Muçaj, është përforcimi i radhës nga skuadra e Vushtrrisë. "Klubi ka arritur marrëveshje me mesfushorin defansiv nga Shqipëria, Ledjon Muçaj, 26-vjeçar i lindur në Fier, ku ishte paraqitur në disa skuadra nga Superliga Shqiptare", thuhet në njoftimin e Vushtrrisë. Muçaj ka luajtur në të kaluarën për KF Bylis, KF Apolonia, KF Besa e Kavajës, derisa gjatë sezonit vjeshtor 2018 ishte pjesë e Gjilanit, kurse në sezonin pranveror iu bashkua skuadrës së Ballkanit nga Suhareka.

### Dilmen: Muriqi, transferimi më i qëlluar në vitet e fundit

Ish-sulmuesi i Fenerbahçes, Ridvan Dilmen, ka vlerësuar lart paraqitjet e Vedat Muriqit te skuadra turke. Muriqi këtë verë nga Rizespori kaloi te Fenerbahce për ta bërë hapin më të madh në karrierë. Deri më tani sulmuesi nga Prizreni ka regjistruar disa paraqitje të mira, duke dhënë sinjalet e para si një transferim i qëlluar. Se Muriqi është transferim i qëlluar nuk ka asnjë dyshim Ridvan Dilman. "Me vite të tëra janë shpenzuar para të mëdha, por një lojtar i ri dhe me vetëbesim të madh, Vedat Muriqi, është transferimi më i qëlluar në vitet e fundit. Ersun Yanal duhet të krijojë një sistem të lojës përreth tij, ku do ta ndihmonte edhe Max Kruse", ka pohuar 56-vjeçari, i cili në të kaluarën ka luajtur për shtatë sezone te Feneri.

### Rashani, afër kalimit në Amerikë

E ardhmja e Elbasan Rashanit mund të jetë në kampionatin amerikan "MLS". Sipas medies norvegjeze "telemarksavisa", për 26-vjeçarin ka shfaqur interes klubi i njohur DC United, pjesë e të cilit është edhe futbollisti me famë botërore Waney Rooney. Klubet amerikane skautojnë prej shumë vitesh në kampionatet skadinave, ku marrin çdo sezon lojtarë të dallueshëm. Kontrata e Rashanit me klubin Ods mbaron pas një viti e gjysmë, çka do të thotë se për kalimin e sulmuesit në ShBA duhet të gjendet pajtimi me drejtuesit e skuadrës norvegjeze. Rashani ka tentuar të luajë dhe më parë jashtë kampionatit norvegjez. 26-vjeçari ka qenë pjesë e danezëve të Brondbit për dy sezone, por aventura daneze nuk rezultoi e frytshme për sulmuesin e krahut.

## Mulaomeroviqi zgjedh 12-shen përfundimtare

Prishtinë, 1 gusht - Përzgjedhësi i Kosovës, Damir Mulaomeroviq, ka zgjedhur 12 basketbollistët që do të luajnë në ndeshjet ndaj Luksemburgut dhe Britanisë së Madhe në kuadër të ndeshjeve parakualifikuese për "Eurobasket 2021". Kosova më 3 gusht ballafaqohet me Luksemburgun në udhëtim, kurse më 7 gusht në palestrën "Minatori" në Mitrovicë do të ballafaqohet me Britaninë e Madhe. Më 14 gusht e pret Luksemburgun në Mitrovicë, kurse ndeshja e fundit është kundër Britanisë së Madhe më 17 gusht. Fituesi i grupit kualifikohet në rrethin e ardhshëm. Lista e basketbollistëve: Divine Myles, Valon Bunjaku, Dardan Berisha, Mikaile Tmusiq, Edmond Azemi, Drilon Hajrizi, Erjon Kastrati, Gëzim Morina, Fisnik Rugova, Meriton Ismaili, Dardan Kapiti, Samir Zekiqi.



## Berisha: Do të kemi një kampionat të mirë me SPAL-in

FERRARA, 1 GUSHT - Etrit Berisha, portieri i SPAL-it, foli për aventurën e re në Serinë A, pas largimit nga Atalanta: "Ne futbollistët jemi mësuar t'i ndryshojmë skuadrat. Është muaji im i parë te SPAL dhe jam duke punuar mirë. Çdo ditë që kalon më bën të ndihem më mirë në këtë klub. Përvoja tek Atalanta? Në tre vjet atje kemi bërë një punë të shkëlqyeshme. Unë do t'i sjell gjërat më të mira të atjeshme te SPAL".
Portieri kuqezi foli edhe për të ardhmen me skuadrën e SPAL-it, duke thënë se të gjithë në klub besojnë se do të kenë një kampionat të mirë. "Po përpiqem të jap gjithçka te skuadra ime e re. Shoh një dëshirë të madhe për të punuar shumë dhe bërë mirë. Të gjithë besojmë se mund të bëjmë një kampionat të mirë. Semplici, ndryshe nga Gasperini? Rregullat kanë ndryshuar, gjithashtu. Këtë sezon portierët te SPAL do të jenë protagonistë. Aksioni mund të nisë nga ne. Trajneri ynë dëshiron ta nisë lojën nga pas, ta ndërtojë manovrën e portierëve", ka deklaruar Berisha.



# Ajeti: Shpresojmë në paraqitje të mira

PRISHTINË, 1 GUSHT - Ditët po numërohen derisa Kampionati Evropian, Divizioni B për femra U20, po afrohet. Basketbollistet e Kosovës po përgatiten maksimalisht edhe pse do ta kenë shumë vështirë, pasi ndodhen në një grup shumë të vështirë, ku do të ballafaqohen me Turqinë dhe Rumaninë. Megjithatë, lojtaret e Kosovës shpresojnë të fitojnë përvojë dhe me ndihmën e publikut të zhvillojnë ndeshje të mira.
Basketbollistja e Kosovës, Fjolla Ajeti, ka folur për përgatitjet deri më tani që i kanë zhvilluar. "Jemi munduar të stërvitemi maksimalisht për këtë Evropian që zhvillohet në shtëpinë tonë. Do të mundohemi të bëjmë paraqitje sa më të mira. Shpresojmë se publiku do të na përkrahë në takimet që kemi", ka thënë Ajeti për faqen zyrtare të FBK-së. Ajo ka folur edhe për rëndësinë që ka ky evropian. "Për ne është shumë i rëndësishëm sepse është hera e parë që marrim pjesë në një ngjarje kaq madhore me U20. Debutojmë pikërisht në shtëpinë tonë, prandaj ndihma e publikut është shumë e rëndësishme", ka shtuar Ajeti.



Në fund foli edhe për kundërshtarët e Kosovës në grupe. "Kemi përballë dy shtete shumë të fuqishme. Ne synojmë të fitojmë përvojë, sepse jemi vasha të reja, por angazhimi ynë në fushë nuk do të mungojë", ka përfunduar Ajeti.
Kosova më 3 gusht ndeshet me Turqinë, kurse dy ditë më pas me Rumaninë. Kjo është hera e parë që një Evropian i Divizionit B zhvillohet në Kosovë, ku do të marrin pjesë 12 shtete, që janë të ndara në katër grupe me nga tri ekipe.

# Franca kërkon pikë olimpike në Botërorin e Basketbollit

BEIJING, 1 GUSHT - Në fund të këtij muaji nis kampionati Botëror i Basketbollit për meshkuj që do të zhvillohet në Kinë. Përfaqësuesja franceze ka nisur tashmë përgatitjet për këtë eveniment ku ShBA-ja është kampione në fuqi me skuadrën amerikane që ditët e fundit është përballur me braktisjen e lojtarëve kryesorë të saj si James Harden, Anthony Davis, Kevin Love, Damian Lillard etj.
Botërori i Basketbollit është në të njëjtën kohë edhe mundësia më e mirë për t'u kualifikuar në Lojërat Olimpike të Tokios dhe Franca duhet të jetë një prej 2 skuadrave më të mira evropiane në këtë Kupë Bote për ta siguruar pjesëmarrjen në ngjarjen më të rëndësishme sportive të vitit të ardhshëm. Por ekziston edhe një mundësi tjetër për të qenë në "Tokyo 2020"; kualifikimi për në 1/8 e finaleve të Botërorit dhe fitorja në një prej turneve kualifikuese për Olimpiket. "Unë preferoj kualifikimin e drejtpërdrejtë për në Lojërat Olimpike të Tokyos që



është edhe rruga më e komplikuar", tha trajneri i përfaqësueses franceze Vincent Collet, duke shtuar se "kjo do të thotë se ne duhet të jemi të paktën në gjysmëfinale dhe ka shumë mundësi që në podium të jenë dy skuadra evropiane".
Trajneri i Bluve bëri me dije se do ta publikojë listën e 12 basketbollistëve me të cilët do të shkojë në Botërorin e Kinës gjatë fazës përgatitore që skuadra do ta zhvillojë në Lyon më 11-17 gusht.
Stafi ka të drejtën që të marrë me vete edhe një lojtar të 13 në rast se do të ketë ndonjë dëmtim të paparashikuar gjatë turneut. Franca ndodhet në Grupin G të Botërorit të Kinës së bashku me Republikën Domenikane, Gjermaninë dhe Jordaninë.

## SHKURT

### Hetemaj rikthehet te Brescia

Mesfushori shqiptar Përparim Hetemaj do të rikthehet te Brescia. Ai ka arritur marrëveshje me Brescian, që ka nisur negociatat me skuadrën e Chievos për lirimin e tij. 32-vjeçari te Chievo është prej vitit 2011 kur u transferua po nga Brescia, ku luajti një edicion dhe regjistroi 34 paraqitje dhe shënoi dy gola.

### Unitedi, 80 milionë euro për Maguiren

Sipas "TalkSport", Manchester United i ka ofruar 80 milionë sterlina (rreth 90 milionë euro) Leicesterit për Harry Maguire. Kjo do të jetë oferta e fundit e "Djajve të Kuq" dhe "Dhelprat" kanë kohë deri të hënën për të dhënë një përgjigje përfundimtare. Në rast se ky operacion do të realizohet, anglezi do të bëhej mbrojtësi më i shtrenjtë i historisë së futbollit, duke kaluar Virgil Van Dijk. Ndërkohë, ka ardhur një detaj domethënës nga Leicesteri, që ka përjashtuar Maguire nga videoja që zbulon numrat e lojtarëve për sezonin e ri.

### Cavani refuzon Interin

Vështirësitë që po has Interi për të gjetur një sulmues klasi janë shumë të mëdha. Pas Lukakut, i cili duket larg zikaltërve, tashmë vjen edhe një refuzim tjetër. Siç raporton "Sport Mediaset", plani B i Interit quhet Edison Cavani, i cili ka dhe një vit kontratë me PSG-në. Por uruguaiani dëshiron të qëndrojë në Paris dhe ta vazhdojë aventurën franceze. Tashmë do të jetë shumë e vështirë për Interin ta bindë lojtarin pasi ai duket i prerë në vendimin e tij. Trajneri Antonio Conte duhet të presë ende për një sulmues, pasi deri tani të gjitha "pistat" e merkatos për repartin ofensivë janë bllokuar.

### Leao, lojtar i Milanit

AC Milan ka transferuar edhe zyrtarisht portugezin Rafaelo Leao nga Lille për 30 milionë euro. Klubi kuqezi njoftoi se Leao ka nënshkruar kontratë pesëvjeçare të enjten. Mësohet se Milani i ka paguar 30 milionë euro për sulmuesin, ndërsa pesë milionë të tjera do t'i paguajë në formë të bonuseve. 20-vjeçari shpërtheu sezonin e kaluar për Lille, duke i shënuar tetë gola dhe duke i ndihmuar klubit ta zërë vendin e dytë në Ligën 1 pas Paris Saint-Germainit. Ai vjen si zëvendësues i Patrick Cutrones, i cili iu bashkua Wolves këtë javë dhe bëhet blerja e tretë e Milanit këtë verë pas Rade Krunic dhe Theo Hernandez.

### Dënohen pilotët e Alfa Romeos, marrin pikë pilotët e Mercedesit

Vendimi i marrë pas garës së Grand Prixit të Gjermanisë i solli pikë të reja Lewis Hamiltonit të Mercedesit si dhe Robert Kubicës së Williamsit. Pikët iu shënuan kampionit në fuqi dhe polakut falë sanksioneve ndaj pilotëve të skuadrës së Alfa Romeos. Kimi Raikkonen dhe Antonio Giovinazzi u dënuan me 30 sekonda për thyerjen e rregullave gjersa nuk kanë respektuar disa rregulla të sigurisë pasi kanë filluar reshjet e shiut. Raikkoneni e përfundoi garën në të shtatin dhe Giovinazzi në të tetin vend, por u zhvendosën në të 12-tin dhe 13-tin për shkak të penalltisë. Britanikut iu njoh pozita e nëntë në vend të 11-të dhe kështu i takuan dy pikë gjersa Robertit i takoi pozita e dhjetë dhe mori një pikë. Ndryshe, Hamiltoni po e kryeson kampionatin në renditjen e ngasësve, ashtu sikurse edhe Mercedesi në garën për konstruktor.



**Autor: GAZMEND MORINA**

PRERË DEGËT E TEPËRTA QË I MARRIN USHQIMIN NJË PEME
TMERRUAR
SKANDALET
REOMIR, ERBIUM
REGJISORJA SHQIPTARE .... ELEZI
AKTORJA AUSTRALIANE KIDMAN (shqip.)
SMALTIMI
VOZA E DJATHIT, TIRA
ANCONA
EPOKA E RE
DËSHIROJ

VEGËL MUZIKORE FRYMORE
BASHKËTING. / SHKENCA MBI MORALI

GJYKIMI I NJË NDESHJE SPORTIVE
EUROPEAN UNION / PUNIM I ARËS

MUZIKA E SHTHURUR / KUNDËRSHTAR I BOLSHEVIZMIT RUS

FUTBOLLISTI ARGJENTINAS SANTIAGO / TEPSI METALI A BALTE (shq.)
UNITED NATIONS

PASURI E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA (turq.)
AKTORI ÇELAJ (shq.) / KËNGË DJEPI

KOLOS
VESHJE E SIPËRME PREJ SHAJAKU / SHENJA NDËRKOMBËTARE PËR KAMION

UGANDA, TAJVANI
QYTET NË KOSOVË (pashq.) / AUTOMJETI, VETURA
ZANORE / KOMPOZITORI WOLFGANG ……. MOZART
PËREMËR VETOR
PROVIM

ANIJATA; PJESA E BRENDSHME E NJË KISHE, QË SHTRIHET NË MES DY RRESHTASH ME SHTYLLA
AKTORI AMERIKAN NË FOTO
AVULL QË DEL NGA TOKA
FUTBOLLISTI BEHRAMI
ZAKONI
DESPOTIK
SHTET NË EVROPË (pashq.) / FILM I YNI "... ISHIN KATËR"
BURIM, GURRË (sh.shq.) / JETË PA TRAZIME

RIFAT AVDIU / ZANORE
PËRGËZIM / VEND LUFTIMI I GLADIATORËVE
"TENERIFE" / KËNGËTARJA FRANCEZE PARADIS

I UJITA
NDEZ / SHTET I VOGËL NË AMERIKË
QYTET NË ZVICËR / BEL I TRUPIT TË NJERIUT

SËMUNDJE E RËNDË NGJITËSE
TRUP GJEOMETRIK / BANJË ALLATURKA (shq.)
BASHKËTING. / AGIM SOPI

NDËRTESË PRANË UDHËS QË SHËRBENTE SI BUJTINË PËR UDHËTARËT (sh.pashq.)
SHKRIMTARJA KADARE / LËNDË MJEKUESE QË HAP OREKSIN
LLOJ LËNDE PLASËSE (shq.)

NJËZET E KATËR DËSHMITARË, QË DËSHMONIN PËR DIKË DIKTATOR SOVJETIK
PEMË E VENDEVE TROPIKALE / BASHKËTING.
REPER AMERIKAN KANYE .... (shqip.) / LAPSI

ZANORE
ARË E MBJELLË ME ORIZ
PJESA E SIPËRME E TRUPIT TË NJERIUT QË QËNDRON MBI QAFËN
KËNGËTARJA LIBOHOVA / AMERICAN MILITARY UNIVERSITY
ANTON PASHKU / QYTET UNIVERSITAR NË ANGLI
"K" para dy "S" / BASHKËTING.
SHKRONJA XXIV / LLOJ PIJE ALKOOLIKE

RRUGICË
PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE / IPSVICH
AKTORJA HOLLIVUDIANE LONGORIA / U BËRA ME PIKA UJI
BISHË MALI (pashq.) / PJESË E HAPUR NË MURIN E NJË NDËRTESE

METAL I FORTË ME NGJYRË HIRI (CR)
QË I PESHON MIRË VEPRIMET A FJALËT / QYTET I LASHTË ILIR
DY BASHKËTINGËLLORE / VENEZIA, OTRANTO
UMA TURMAN

E ARRATISUR
INDONEZIA / NGJYRË E LËKURËS SË FYTYRËS
REGJISORI ...... STONE / DY ZANORE
"MONZA" / ENË E MADHE PËR TË ZIER UJË

LEJA PËR TË SHKUAR NGA ODA
ISMET TOTO / NIS TË ZBARDHË DITA
QË LIDHET ME ANATOMINË / PILOTI I "FORMULA 1" HAKINEN
LUGANO / SUPER MODELJA BRAZILIANE ADRIANA

XHAMAJKA, OMANI
BASKETBOLLISTI EDMOND / GRIMCOVA (bised.)
GROSETO, IVREA / BIMË ME TRUNG TË TRASHË
SHTET NË EVROPË / LLO DRURI (pashq.)

EPOKA E RE
BIMË QË PËRDORET SI ERËZ PËR GJELLË (shq.) / NOTË MUZIKORE
KËNGËTARJA .... GJERGJI / ZANORE
NJË KONTINENT / ARIAN MALIQI
INDIUM

QENIE MBINJERËZORE ME FUQI TË FSHEHTË (mit.)
NË ÇFARË KOHE / SHKRONJA XVI
BASHKËTING.
DIÇKA QË NUK ËSHTË FITUAR ME PUNË TË NDERSHME / EVERTON

ZANORE
KËNGËTARJA JONË ..... MIMANI
LLOJ VEGLE MUZIKORE
MUZIKANTI KISERI

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: KLARINETA, D, REFERIMI, EU, AMERIKANATA, ESER, SOLARI, IRAT, LIRAKU, TITAN, MITAN, UT, VITI, I, RUMANI, AMAT, NAVATA, RA, URIM, TE, I VADITA, KALL, DAVOS, KOLERA, PIRAMIDA, T, POROTA, HANE, ELENA, LENIN, ANANAS, UEST, A, IRMA, AP, KSS, R, SOKAK, AMI, EVA, ARI, KROM, I MATUR, LD, UT, E IKUR, I, OLIVER, MO, IZA, IT, ANATOMIK, L, XHO, AZEMI, GI, ITALI, RIGONI, DAVA, AZI, DEMON, KUR, HARAMI, O, ANILA, UTE, MENAN.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit të Komunës**

Udhëheqësi I Personelit/Rukovodilac Personala/Heand of Personnel

**Nr. 111/01-0048090/19**
**Skenderaj, më 01 Gusht 2019.**

Udhëheqësi i Personelit, duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 2,nenin 11, paragrafi 1 dhe 2, nenin 12 paragrafi 3, neni 18,paragrafi 1,neni 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Shërbimin Civil nr.03/L-149,dhe Rregulloren nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit ne SHC si dhe pas autorizimit për shpalljen e konkursit nga MAP përmes SIMBNJ nga DASHC për pozitat e lira për një,Udhëheqës për Komunikim me Publikun , IN/010 / JP00040129 më 01 Gusht 2019,vendosi të shpallë këtë:

## K O N K U R S

Për plotësimin një (1) vendi të lirë të punës në organet e Administratës të Komunës së Skenderajt.

**Emri i Institucionit: Komuna e Skenderajt—Zyra e Kryetarit**
**Pozita e punës:** Udhëheqës për Komunikim me Publikun.
**Numri i Ekzekutuesve** 1
**Kodi Buxhetor:**16023
**Kategoria funksionale**: Profesional 1
**Grada e vendit të punës**: Koeficienti 8
**Lloji i vendit të punës:** I karrierës, më orar të plotë(40)orë.
**Raporton**: Kryetarit të Komunës
**Vend ndodhja** :Komuna Skenderaj - Zyra e Kryetarit.
**-Përshkrimi i detyrave të punës:** Udhëheq Sektorin e Komunikimit Publik dhe cakton objektivat si dhe zhvillon planit e punës për përmbushjen e këtyre objektivave, menaxhon stafin e sektorit dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve cilësore, siguron hartimin dhe zbatimin e planit të komunikimit për të informuar qytetarët, institucionet dhe komunitetin e biznesit për politikat, arritjet dhe aktivitetet e komunës dhe siguron redaktimin dhe përditësimin e tyre, harton kalendarin e mbulimit medial të aktiviteteve të komunës, dhe i harmonizon me kalendarin e mbulimit medial në nivel komunal si dhe komunikon me media, siguron aplikimin e standardeve të komunikimit publik, nëpërmjet trajnimit dhe avancimit, me qëllim që funksionet e zyrës të ushtrohen në mënyrën më efektive dhe efikase, zëvendëson zëdhënësin e komunës në mungesë të tij dhe bashkëpunon me zyrën për informim për të siguruar që politikat dhe arritjet e komunes të prezantohen në kuadër të njoftimeve të komunës, siguron hartimin dhe zhvillimin e politikave të fjalimeve dhe opinioneve për të gjitha temat e rëndësishme lidhur me aktivitet dhe shërbimet e komunës, bënë vlerësim të rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara
**Kualifikimi: Përgatitja profesionale:** Diplome Universitare se paku 5 vite përvojë pune.

- Përveç kushteve të parapara me ligj, kandidati duhet t'i plotësoj kushtet si në vijim:
- Një CV të shkurtër.
- Të këtë shkathtësi dhe aftësi profesionale për këtë vend pune.
- Kandidati duhet të jetë i gatshëm të punojë nën presion dhe në shoqëri multietnike.
- Shkathtësi dhe aftësi të mira komunikimi.
- Njohja e gjuhëve zyrtare.
